

KUSHTETUTA
E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME
TË KOSOVËS

Në bazë të nenit 85 alineja 1 pika 1 nenit 96 alineja 1 pika 1 dhe nenit 127 alineja 4 të Ligjit kushtetues të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave më 27 shkurt 1974, merr këtë

V E N D I M

MBI SHPALLJEN E KUSHTETUTËS SË KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

Shpallet Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të cilën e aprovoi Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në mbledhjen e të gjitha dhomave më 27 shkurt 1974.

KK Nr. 010-8
Prishtinë, më 27 shkurt 1974

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

**Kryetari i Kuvendit,
Iljaz Kurteshi, d. v.**

Vendimi, bashkë me tekstin e Kushtetutës, është shpallë në „Gazetën Zyrtare të KSAK”, nr. 4 të 27 shkurtit 1974.

Duke u nisur nga fakti se punëtorët e fshatarët dhe njerëzit përparimtarë të të gjitha kombeve e kombësive të Kosovës, të bashkuar në Frontin nacionalçlirimtar me Partinë komuniste në krye, me luftën e vet bashkë me kombet e kombësitë e tjera të Jugosllavisë në luftën nacionalçlirimtare dhe në revolucionin socialist, përmbysën rendin e vjetër klasor të bazuar në shfrytëzim, shtypje politike e pabarazi kombëtare dhe filluan të krijojnë shoqërinë në të cilën puna e njeriut dhe njeriu do të çlirohen nga shfrytëzimi e arbitrariteti dhe ku do të krijohen kushtet për zhvillimin të lirë e të gjithanshëm të të gjitha kombeve e kombësive;

duke pasur parasysh se me zhvillimin e bazës materiale të vendit e të marrëdhënjeve shoqërore-socialiste, si dhe me ndërtimin e mëtejshëm të marrëdhënjeve të bazuara në vetëqeverisje dhe në barazinë kombëtare, u realizuan ndryshime qenësore në marrëdhënjet shoqërore e politike, që kërkojnë ndryshime përkatëse të Ligjit kushtetues të Krahinës të vitit 1969, disa dispozita të të cilit janë ndryshuar esencialisht me amendamentet e vitit 1972;

me qëllim që të përforcohen e të zhvillohen më tutje frytet e arritura revolucionare, të sigurohet zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse demokratike në rrugën e çlirimit të punës e të ndërtimit të shoqërisë komuniste, të vazhdojnë proceset e zhvillimit të mëtejshëm dhe më të shpejtë të Krahinës, të thellohet më tutje barazia e kombeve dhe e kombësive në Krahinë dhe të zhvillohet vëllazërimi e bashkimi me kombet e kombësitë e RS të Serbisë e të RSF të Jugosllavisë, që me Kushtetutën e Krahinës të përforcohet më tutje sistemi kushtetues në baza unike vetëqeverisëse socialiste,

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, duke shprehur vullnetin e kombeve e të kombësive, të klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punues të Krahinës,

n x j e r

KUSHTETUTËN

E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

PARIMET THEMELORE

I

Të ndërlidhur në të kaluarën e vet dhe me jetën e synimet e përbashkëta për liri e progres social, malazetët, muslimanët, serbët, shqiptarët, turqit dhe pjesëtarët e kombeve e të kombësive të tjera dhe të grupeve etnike, në luftën e përbashkët të të gjitha kombeve e kombësive të Jugosllavisë në Luftën nacionalçlirimtare dhe në revolucionin socialist, të udhëhequr nga klasa punëtore dhe Partia komuniste e Jugosllavisë, përmbysën rendin e vjetër klasor të bazuar në shfrytëzim, shtypje politike e pabarazi kombëtare dhe u gjendën për herë të parë të lirë, të barabartë dhe të vëllazëruar në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, e cila u bë formë politike e shoqërore si e lidhshmërisë së fortë dhe e barazisë reciproke të tyre, ashtu edhe e barazisë së tyre me kombet e kombësitë e Jugosllavisë.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës u krijua në luftën e përbashkët të kombeve e të kombësive

në Luftën nacionalçlirimtare dhe në revolucionin socialist të Jugosllavisë dhe, në bazë të vullnetit të shprehur lirisht të popullsisë — të kombeve e të kombësive të Kosovës dhe vullnetit të shprehur lirisht të popullit të Serbisë, u bashkua në Republikën Socialiste të Serbisë në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Njerëzit punues dhe kombet e kombësitë e Kosovës realizojnë të drejtat e veta sovraane në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, e kur kjo është në interes të përbashkët të njerëzve punues dhe të kombeve e të kombësive të Republikës si tërësi e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë edhe në Republikë, dhe në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, kur kjo është përcaktuar në interes të përbashkët me Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Në realizimin e interesave të përbashkëta, njerëzit punues, kombet e kombësitë e Kosovës vendosin në Federatë mbi parimet e marrëveshjes reciproke të republikave e të krahinave autonome, të solidaritetit e të reciprocitetit, të pjesëmarrjes së barabartë të republikave e të krahinave autonome në organet e Federatës në pajtim me Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe me Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, si dhe mbi parimin e përgjegjësisë së republikave e të krahinave autonome për zhvillimin e vet dhe për zhvillimin e bashkësisë socialiste të Jugosllavisë si tërësi.

II

Njerëzit punues të Kosovës realizojnë të drejtat e veta në sistemin unik shoqëror-ekonomik e politik të bazuar në pushtetin e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues dhe në marrëdhënjet midis njerëzve si prodhues dhe krijues të lirë e të barabartë, puna e të cilëve shërben ekskluzivisht për plotësimin e nevojave të tyre personale e të përbashkëta.

Bazën e këtyre marrëdhënjeve e përbën pozita shoqërore-ekonomike e njeriut punues, e cila i sigu-

ron që, duke punuar me mjetet në pronësinë shoqërore dhe duke vendosur në mënyrë të drejtpërdrejtë e të barabartë me njerëzit e tjerë punues në punën e bashkuar mbi të gjitha punët e riprodhimit shoqëror në kushtet dhe në marrëdhënjet e varësisë, të përgjegjësisë e të solidaritetit reciprok, të realizojë interesin e vet personal material e moral dhe të drejtën që të shfrytëzojë rezultatet e punës së vet vijuese e të tejshkuar dhe frytet e përparimit të përgjithshëm material e shoqëror, që mbi këtë bazë të plotësojë në mënyrë sa më të plotë nevojat e veta personale e shoqërore dhe të zhvillojë aftësitë e veta të punës dhe aftësitë e tjera krijuese.

Në pajtim me këtë, bazën e pacenueshme të pozitës dhe të rolit të njeriut e përbëjnë:

pronësia shoqërore mbi mjetet e prodhimit, e cila përjashton kthimin e çfarëdo sistemi të eksploatimit të njeriut dhe e cila, me zhdukjen e tjetërsimit të klasës punëtore dhe të njerëzve punues nga mjetet e prodhimit dhe nga kushtet e tjera të punës, siguron vetëqeverisjen e njerëzve punues në prodhim e në ndarjen e produkteve të punës dhe orientimin e zhvillimit të shoqërisë në baza të vetëqeverisjes;

çlirimi i punës si eliminim i pabarazive shoqërore-ekonomike dhe i varësisë së njerëzve në punë, të kushtëzuara historikisht, që sigurohet me zhdukjen e kontradiktave midis punës e kapitalit dhe të çdo forme të marrëdhënjeve mëditore, me zhvillimin e gjithanshëm të forcave prodhuese, ngritjen e produktivitetit të punës, zvogëlimin e kohës së punës, zhvillimin dhe aplikimin e shkencës e të teknikës, sigurimin e arësimit gjithnjë e më të lartë për të gjithë dhe me ngritjen e kulturës së njerëzve punues;

e drejta për vetëqeverisje, në bazë të së cilës çdo njeri punues, në mënyrë të barabartë me njerëzit e tjerë punues, vendos mbi punën e vet, kushtet dhe rezultatet e punës, mbi interesat personale të përbashkëta dhe mbi orientimin e zhvillimit shoqëror, realizon pushtetin dhe drejton punët e tjera shoqërore;

e drejta e njeriut punues që t'i gëzojë frytet e punës së vet dhe të përparimit material të bashkësisë shoqërore sipas parimit: „Secili sipas aftësive

— secilit sipas punës së tij”, me obligimin e tij që të sigurojë zhvillimin e bazës materiale të punës së vet e të punës shoqërore dhe të kontribuojë për plotësimin e nevojave të tjera shoqërore;

siguria ekonomike, sociale dhe personale e njeriut;

solidariteti dhe reciprociteti i secilit ndaj të gjithëve dhe i të gjithëve ndaj secilit, që bazohen në vetëdijen e njerëzve punues se interesat e veta të përhershme mund t'i realizojnë vetëm mbi këto parime;

iniciativa e lirë në zhvillimin e prodhimit dhe të veprimtarive të tjera shoqërore e personale në dobi të njeriut dhe të bashkësisë shoqërore;

marrëdhënjet politike demokratike, që i bëjnë të mundur njeriut të realizojë interesat e veta, të drejtën e vetëqeverisjes dhe të drejtat e tjera, të zhvillojë personalitetin e vet me aktivitet të drejtë-përdrejtë në jetën shoqërore, e sidomos në organet e vetëqeverisjes, organizatat shoqërore-politike dhe në organizatat e tjera shoqërore e shoqatat, që i krijojnë vetë dhe nëpërmjet të cilave ndikon në zhvillimin e vetëdijes shoqërore dhe në zgjerimin e kushteve për aktivitetin e vet për realizimin e interesave dhe të drejtave të veta;

barazia e të drejtave, detyrave dhe përgjegjësisive të njerëzve, në pajtim me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.

Sistemi shoqëror-ekonomik dhe sistemi politik rrjedhin nga pozita e këtyre të drejtave të njeriut dhe i shërbejnë atij dhe rolit të tij në shoqëri.

Është në kundërshtim me sistemin shoqëror-ekonomik dhe sistemin politik, të përcaktuar me këtë Kushtetutë, çdo formë e drejtimit të prodhimit e të veprimtarive të tjera shoqërore dhe çdo formë e ndarjes që deformat marrëdhënjet shoqërore të bazuara në pozitën e këtyre të drejtave të njeriut — në formë arbitrariteti burokratik, uzurpimi teknokratik dhe privilegjeve të bazuara në monopolin e drejtimit të mjeteve të prodhimit, ose në formë përvehtësimi të mjeteve shoqërore në bazë të pronësisë së grupeve dhe të formave të tjera të privatizimit të këtyre mjeteve, ose në formë egoizmi pronaro-privat ose partikularist, si dhe çdo formë tjetër e kufizimit të klasës

punëtoresh që të realizojë rolin e vet historik në marrëdhënjet shoqërore-ekonomike e politike dhe të organizojë pushtetin për vete dhe për të gjithë njerëzit punues.

III

3 -- Pronësia shoqërore, si shprehje e marrëdhënjeve shoqërore-ekonomike socialiste midis njerëzve, është bazë e punës së lirë të bashkuar dhe e pozitës sunduese të klasës punëtoresh në prodhim dhe në riprodhimin shoqëror në tërësi, si dhe bazë e punës personale të fituar me punë personale e cila shërben për plotësimin e nevojave dhe interesave të njeriut.

Mjetet e prodhimit në pronësinë shoqërore, si bazë e përbashkët e patjetërsueshme e punës shoqërore dhe e riprodhimit shoqëror, shërbejnë ekskluzivisht për punë me qëllim plotësimi të nevojave dhe të interesave personale e të përbashkëta të njerëzve punues dhe për zhvillimin e bazës materiale të shoqërisë socialiste dhe të marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse. Mjetet e prodhimit në pronësinë shoqërore, duke i përfshirë edhe mjetet e riprodhimit të zgjeruar, i drejtojnë drejtpërdrejt punëtorët e bashkuar që punojnë me këto mjete, në interes të tyre dhe në interes të klasës punëtoresh e të shoqërisë socialiste. Në realizimin e këtij funksioni shoqëror punëtorët e bashkuar janë përgjegjës para njëri-tjetrit dhe para bashkësisë socialiste si tërësi.

Me pronësinë shoqërore mbi mjetet e prodhimit dhe mjetet e tjera të punës i sigurohet secilit që, në kushte të barabarta, të hyjë në punën e bashkuar me mjetet shoqërore dhe që, duke realizuar të drejtën e punës me mjetet shoqërore, në bazë të punës së vet të fitojë të ardhura për plotësimin e nevojave personale dhe të përbashkëta.

Duke u nisur nga fakti se askush nuk ka të drejtë pronësie mbi mjetet shoqërore të prodhimit, askush — as bashkësia shoqërore-politike, as organizata e punës së bashkuar, as grupi i qytetarëve, as individit — në kurrëfarë baze juridike-pronësore nuk mund të përvetësojë produktin e punës shoqërore, as t'i drejtojë e t'i disponojë mjetet shoqërore të

prodhimit e të punës, as t'i caktojë në mënyrë arbitrare kushtet e ndarjes.

Puna e njeriut është e vetmja bazë e përvetësimit të produkteve të punës shoqërore dhe e drejtimit të mjeteve shoqërore.

Mbi ndarjen e të ardhurave në pjesën që shërben për zgjerimin e bazës materiale të punës shoqërore dhe në pjesën për plotësimin e nevojave personale e të përbashkëta të njerëzve punues në pajtim me parimin e ndarjes sipas punës, vendosin njerëzit punues që i krijojnë këto të ardhura, në pajtim me përgjegjësinë e solidaritetin reciprok dhe me bazat e kriteret shoqërisht të përcaktuara për fitimin dhe ndarjen e të ardhurave.

Mjetet e destinuara për përtrirjen dhe zgjerimin e bazës materiale të punës shoqërore janë bazë e përbashkët e qenjes dhe e zhvillimit të shoqërisë, dmth. e riprodhimit shoqëror, të cilën në bazë të vetëqeverisjes e realizojnë njerëzit punues në të gjitha format e bashkimit të punës e të mjeteve dhe në bashkëpunimin reciprok të organizatave të punës së bashkuar.

— Bazë e të gjitha formave të bashkimit të punës e të mjeteve të riprodhimit shoqëror dhe e integritetit vetëqeverisës të punës së bashkuar është organizata themelore e punës së bashkuar, si formë themelore e punës së bashkuar, në të cilën punëtorët realizojnë të drejtën e patjetërsueshme që, duke punuar me mjetet shoqërore, të drejtojnë punën e vet e kushtet e punës dhe të vendosin mbi rezultatet e punës së tyre. —

Duke realizuar rezultatet e punës së përbashkët si vlerë në treg në kushtet e prodhimit socialist të mallrave, punëtorët me ndërlidhjen e drejtpërdrejtë, me marrëveshje vetëqeverisëse dhe me marrëveshje shoqërore të organizatave të veta të punës së bashkuar dhe të organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse dhe me planifikimin e punës e të zhvillimit integrojnë punën shoqërore, përparojnë sistemin e tërësishëm të marrëdhënjeve shoqërore-ekonomike socialiste dhe përballojnë veprimin stihik të tregut.

— Sistemi monetar dhe sistemi kreditor janë pjesë përbërëse e marrëdhënjeve në riprodhimin shoqëror

të bazuara në vetëqeverisjen e punëtorëve në punën e bashkuar me mjetet shoqërore dhe të ardhurat e gjithmbarshme të realizuara në këto marrëdhënje janë pjesë e patjetërsueshme e të ardhurave të organizatave themelore të punës së bashkuar. —

Duke u nisur nga varësia reciproke e lëmës së prodhimit, të qarkullimit dhe lëmës financiare të punës së bashkuar, si pjesë të sistemit unik të riprodhimit shoqëror, punëtorët në organizatat e punës së bashkuar rregullojnë marrëdhënjet e veta reciproke në riprodhimin shoqëror dhe bashkëpunojnë mbi atë bazë që punëtorëve në prodhim t'u sigurohet të vendosin mbi rezultatet e punës së tyre vijuese e të tejshkuar në terësinë e këtyre marrëdhënjeve.

Njerëzit punues nevojat dhe interesat e veta personale e të përbashkëta në lëmët e arësimit, shkencës, kulturës, shëndetësisë dhe të veprimtarive të tjera shoqërore, si pjesë të procesit unik të punës shoqërore, i sigurojnë me këmbimin e lirë dhe bashkimin e punës së tyre me punën e punëtorëve në organizatat e punës së bashkuar në këto lëmë. Këmbimin e lirë të punës njerëzit punues e realizojnë drejtpërdrejt, nëpërmjet organizatave të punës së bashkuar dhe në kuadër ose nëpërmjet bashkësive vetëqeverisëse të interesit. Me marrëdhënje të këtilla punëtorëve në këto veprimtari u sigurohet pozita e njejtë shoqërore-ekonomike sikurse punëtorëve të tjerë në punën e bashkuar.

Njerëzit punues, me qëllim plotësimi më të plotë, më racional dhe të organizuar të nevojave e të interesave të veta personale e të përbashkëta në veprimtari të shoqërore dhe në veprimtari të caktuara të prodhimit material, bashkë me punëtorët në organizatat e punës së bashkuar të këtyre veprimtarive, themelojnë bashkësi vetëqeverisëse të interesit në të cilat realizojnë këmbimin e lirë të punës dhe rregullojnë drejtpërdrejt marrëdhënjet me interes të përbashkët. Punëtorët dhe njerëzit punues themelojnë bashkësi vetëqeverisëse të interesit edhe për plotësimin e nevojave dhe interesave të caktuara të veta personale e të përbashkëta me bashkimin e mjeteve sipas parimeve të reciprocitetit e të solidaritetit.

Njerëzit punues që ushtrojnë pavarësisht veprimtari me punë personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve kanë në bazë të punës së vet parimisht të njëjtën pozitë shoqërore-ekonomike dhe në esencë të njëjtat të drejta e obligime sikurse punëtorët në organizatat e punës së bashkur.

— Duke gëzuar të drejtën e pronësisë mbi tokën e punëshme, të përcaktuar me Kushtetutë, bujqit kanë të drejtë dhe obligim të shfrytëzojnë këtë tokë për përparimin e prodhimit bujqësor në interes të tyre dhe në interes të bashkësisë socialiste. Bashkësia socialiste u jep përkrahje bujqëve për ngritjen e produktivitetit të punës së tyre dhe për bashkimin e lirë në kooperativa e forma të tjera bashkimi për përparimin e kushteve të punës e të jetës së tyre.

Me qëllim inkuadrimit të organizuar të bujqëve në marrëdhënjet shoqërore-ekonomike socialiste vetëqeverisëse dhe të përparimit të prodhimit bujqësor, sigurohen kushtet për zhvillimin e tij në bazë të mjeteve shoqërore e të punës shoqërore si dhe kushtet për bashkimin e bujqëve dhe bashkëpunimin e tyre me organizatat e punës së bashkuar sipas parimeve të vullnetit dhe të barazisë.

Për përparimin e kushteve të jetës e të punës së vet, krijimin e bazës për stabilitetin e tyre dhe shfrytëzimin sa më të plotë të mundësive për zhvillimin e forcave prodhuese të shoqërisë dhe për rritjen e produktivitetit të punës së vet e të punës së tërësishme shoqërore për zhvillimin e marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse mbi këtë bazë si dhe për përballimin e veprimit stihik të tregut, punëtorët në organizatat themleore dhe në organizatat e tjera të punës së bashkuar dhe njerëzit punues në bashkësitë vetëqeverisëse të interesit dhe në organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse, si dhe në bashkësitë shoqërore-politike, duke u mbështetur në të mbërrimet shkencore dhe në vlerësimet e mundësive të zhvillimit të bazuara në to, me planifikimin e punës e të zhvillimit të vet harmonizojnë marrëdhënjet në riprodhimin shoqëror dhe orientojnë zhvillimin e prodhimit shoqëror e të veprimtarive të tjera shoqërore me interesat dhe qëllimet e veta të përbashkëta të përcaktuara në baza të vetëqeverisjes.

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës tërë pushteti i takon klasës punëtore në bashkim me të gjithë njerëzit punues të qytetit e të fshatit.

— Me qëllim ndërtimi të shoqërisë si bashkësi të lirë të prodhuesve, klasa punëtore dhe të gjithë njerëzit punues zhvillojnë demokracinë socialiste vetëqeverisëse si formë të veçantë të diktaturës së proletariatit dhe këtë e sigurojnë:

— me zhdukjen revolucionare dhe me ndalimin me kushtetutë të çdo forme të marrëdhënjeve e të organizatave shoqërore-ekonomike e politike, të bazuara në shfrytëzimin klasor dhe monopolin pronësor dhe të çdo veprimtarie politike të drejtuar në vendosjen e marrëdhënjeve të këtilla;

— me realizimin e vetëqeverisjes në organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë lokale, bashkësive vetëqeverisëse të interesit dhe në organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse, si dhe në bashkësitë shoqërore-politike e shoqërinë në përgjithësi, dhe me ndërlidhjen e bashkëpunimin reciprok të këtyre organizatave dhe bashkësive;

me rregullimin vetëqeverisës të lirë e të barabartë të marrëdhënjeve reciproke dhe me harmonizimin e interesave të përbashkëta e të përgjithshme të njerëzve punues dhe të organizatave e të bashkësive të tyre vetëqeverisëse me marrëveshje vetëqeverisëse dhe marrëveshje shoqërore;

me vendosjen e njerëzve punues në realizimin e pushtetit dhe në drejtimin e punëve të tjera shoqërore në organizatat themelore të punës së bashkuar dhe në organizatat e bashkësitë e tjera themelore vetëqeverisëse, me anë të delegacioneve dhe delegatëve në organet e qeverisjes të organizatave e të bashkësive vetëqeverisëse, si dhe me anë të delegacioneve dhe delegatëve në kuvendet e bashkësive shoqërore-politike dhe në organet e tjera të vetëqeverisjes;

me informimin e njerëzve punues për të gjitha çështjet me rëndësi për realizimin e pozitës së tyre shoqërore-ekonomike dhe për vendosjen sa më të plotë e më të kualifikuar në ushtrimin e funksione-

ve të pushtetit e të drejtimit të punëve të tjera shoqërore;

me publicitetin e punës së të gjitha organeve të pushtetit e të vetëqeverisjes dhe të bartësve të funksioneve vetëqeverisëse, publike e të funksioneve të tjera shoqërore;

me përgjegjësinë personale të bartësve të funksioneve vetëqeverisëse, publike e të funksioneve të tjera shoqërore, me përgjegjësinë e organeve të pushtetit e të vetëqeverisjes, me ndërrueshmërinë e bartësve të funksioneve vetëqeverisëse, publike e të funksioneve të tjera shoqërore dhe me kufizimin e rizgjedhjes e të riemërimit të tyre në funksione të caktuara;

me realizimin e kontrollit të punëtorëve e të njerëzve të tjerë punues dhe të kontrollit shoqëror në përgjithësi mbi punën e bartësve të funksioneve vetëqeverisëse, publike e të funksioneve të tjera shoqërore në organizatat e bashkësitë vetëqeverisëse dhe në bashkësitë shoqërore-politike;

me realizimin dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë;

me veprimtarinë shoqërore-politike të forcave socialiste të organizuara në organizata shoqërore-politike;

me aktivitetet e lira e të gjithanshme të njerëzve.

Vetëqeverisja e njerëzve punues në organizatat themelore të punës së bashkuar, bashkësitë lokale, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit dhe në organizatat e bashkësitë e tjera themelore vetëqeverisëse është bazë e sistemit unik të vetëqeverisjes e të pushtetit të klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues.

Për t'i siguruar kushtet e jetës e të punës së vetë dhe të zhvillimit shoqëror e të krijimit të bashkësisë socialiste, njerëzit punues në komunë, si bashkësitë vetëqeverisëse dhe themelore shoqërore-politike, dhe në bashkësitë e tjera shoqërore-politike, me ndërlidhjen e organizatave të veta të punës së bashkuar dhe të organizatave e të bashkësive të tjera vetëqeverisëse, me veprimin e organizatave shoqërore-politike, me marrëveshjen vetëqeverisëse, marrëveshje shoqërore

dhe me funksionimin e kuvendëve si organe të përbashkëta të të gjithë njerëzve dhe të organizatave e të bashkësive të tyre realizojnë interesat e veta të përbashkëta, ushtrojnë pushtetin dhe drejtojnë punët e tjera shoqërore.

Funksionet e pushtetit e të drejtimit të punëve të tjera shoqërore në bashkësitë shoqërore-politike, të përcaktuara me kushtetutë, i ushtrojnë kuvendet e bashkësive shoqërore-politike, si delegacione të zgjedhura e të ndërrueshme të njerëzve punues në organizata e bashkësi vetëqeverisëse dhe në organizata shoqërore-politike dhe organet e tjera që përgjigjen para kuvendëve.

Për pjesëmarrjen sa më të plotë të njerëzve punues dhe të të gjitha forcave të organizuara socialiste në realizimin e pushtetit e në drejtimin e punëve të tjera shoqërore dhe për harmonizimin e interesave të tyre të përbashkëta e të përgjithshme shoqërore, organet e bashkësive shoqërore-politike shqyrtojnë inisiativat, mendimet dhe propozimet e organizatave shoqërore-politike, marrin qëndrime mbi to dhe bashkëpunojnë me organizatat shoqërore-politike.

Klasa punëtore dhe të gjithë njerëzit punues edhe me anë të pushtetit shtetëror me norma të obligueshme për të gjithë sigurojnë marrëdhënjet shoqërore socialiste, zhvillimin e shoqërisë dhe drejtimin e punëve shoqërore në baza të vetëqeverisjes, mbrojnë liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit, marrëdhënjet socialiste vetëqeverisëse dhe të drejtat vetëqeverisëse të njerëzve punues, zgjidhin konfliktet shoqërore dhe mbrojnë rendin e përcaktuar me kushtetutë.

Pozita dhe të drejtat vetëqeverisëse të njeriut punues në organizatat themelore e organizatat e tjera të punës së bashkuar, në bashkësitë lokale, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit dhe në organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse, pozita vetëqeverisëse e njerëzve punues në komunë, bashkimi i lirë në baza të vetëqeverisjes, aktiviteti dhe krijimtaria e njerëzve punues, barazia e kombeve dhe e kombësive dhe liritë, të drejtat e detyrat e njeriut e të qytetarit, të përcaktuara me kushtetutë, janë bazë, kufi dhe drejtim i realizimit të të drejtave dhe de-

tyrave të bashkësive shoqërore-politike në ushtrimin e funksionit të pushtetit.

Vetëmbrojtja shoqërore, si funksion i shoqërisë vetëqeverisëse, realizohet me aktivitetet e njerëzve punues, të qytetarëve, të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse, të organizatave shoqërore-politike e organizatave të tjera dhe të bashkësive shoqërore-politike, për mbrojtjen e rregullimit kushtetues, të drejtave vetëqeverisëse të njerëzve punues dhe të drejtave e lirive të tjera të njeriut e të qytetarit, për mbrojtjen e pasurisë shoqërore, sigurimin e sigurisë personale dhe pasurore të njerëzve punues e të qytetarëve dhe për zhvillimin e lirë shoqëror.

Për realizimin dhe harmonizimin e interesave dhe të drejtave vetëqeverisëse të tyre në pajtim me interesat e përgjithshme të shoqërisë socialiste, si dhe për kryerjen e punëve të caktuara shoqërore dhe zhvillimin e aktiviteteve të shumëllojshme, njerëzit punues dhe qytetarët bashkohen lirisht në organizata shoqërore-politike e organizata të tjera shoqërore dhe në shoqata të qytetarëve, si pjesë përbërëse të sistemit socialist vetëqeverisës.

Organizatat shoqërore-politike, si formë e organizimit të lirë politik të njerëzve punues në baza klasore socialiste, janë faktor aktiv i zhvillimit dhe i mbrojtjes së shoqërisë socialiste vetëqeverisëse.

V

Liritë, të drejtat dhe detyrat e njeriut e të qytetarit, të përcaktuara me Kushtetutë, janë pjesë e pandarë dhe shprehje e marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse demokratike në të cilat njeriu çlirohet nga çdo shfrytëzim e arbitraritet dhe me punën e vet krijon kushte për zhvillimin e gjithanshëm dhe shprehjen e lirë e mbrojtjen e personalitetit të vet dhe për respektimin e dinjitetit njerëzor. Liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit janë të kufizuara vetëm me liritë dhe të drejtat e barabarta të të tjerëve dhe me interesat e shoqërisë socialiste. Shoqëria socialiste siguron kushtet për realizimin sa më

të plotë dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë. Çdo aktivitet me të cilin shkelet këto liri dhe të drejta të njeriut e të qytetarit është në kundërshtim me interesat e shoqërisë socialiste.

Duke u nisur nga fakti se arësimi, shkenca dhe kultura janë faktor qenësor i zhvillimit të shoqërisë socialiste, ngritjes së produktivitetit të punës, zhvillimit të forcave krijuese të njerëzve dhe zhvillimit të gjithanshëm të personalitetit, humanizimit të marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse dhe përparimit të përgjithshëm të shoqërisë, bashkësia socialiste siguron lirinë e krijimtarisë dhe krijon kushtet për zhvillimin dhe përparimin e arësimit, krijimtarisë shkencore, kulture dhe artistike në mënyrë që t'i shërbejnë sa më me sukses ngritjes së aftësive krijuese të njerëzve punues, përparimit të marrëdhënjeve shoqërore socialiste dhe zhvillimit të gjithanshëm të personalitetit të lirë e të humanizuar.

Edukimi dhe arësimi bazohen në frytet e shkencës bashkëkohore dhe veçanërisht të marksizmit, si baza të socializmit shkencor, i shërbejnë aftësitë të njerëzve punues për punë e për vetëqeverisje dhe edukimit të tyre në frymën e fitoreve të revolucionit socialist, etikës socialiste, demokratizmit vetëqeverisës, patriotizmit socialist, vëllazërimit e bashkimit, barazisë së kombeve e të kombësive dhe të internacionalizmit socialist.

Njerëzit punues në organizata të punës së bashkuar dhe në organizata e bashkësi të tjera vetëqeverisëse, organizatat e punës së bashkuar dhe organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse, në baza të solidaritetit e të reciprocitetit dhe të humanizmit socialist, sigurojnë sigurinë e vet ekonomike e sociale dhe krijojnë kushte gjithnjë e më të volitshme për jetë e punë dhe për zhvillimin e personalitetit të gjithanshëm të njeriut punues. Këto qëllime të politikës sociale realizohen me përmirësimin e vazhdueshëm dhe me barazimin e kushteve të jetës e të punës, me eliminimin, në baza të solidaritetit e të reciprocitetit, të diferencave që rrjedhin nga moszhvillimi material dhe nga kushtet e tjera jo të barabarta të jetës e të punës, me barazimin e

mundësive të arësimit e të punës dhe me pengimin e eliminimit e diferencave sociale që nuk bazohen në aplikimin e parimit të ndarjes sipas punës.

Bashkësia shoqërore siguron mbrojtjen e veçantë të luftëtarëve të Luftës nacionalçlirimtare dhe të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve ushtarakë, të viktimave të terrorit fashist dhe të invalidëve civilë të luftës, të cilëve u garantohet siguria sociale e tyre.

Për mbrojtjen dhe përparimin e ambientit të njeriut njerëzit punues dhe qytetarët, organizatat e punës së bashkuar, organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse dhe shoqëria socialiste sigurojnë kushte për ruajtjen dhe përparimin e vlerave natyrale dhe vlerave të tjera të ambientit të njeriut që janë me interes për jetën dhe punën e shëndoshë, të sigurtë dhe krijues të gjeneratave të tanishme e të ardhshme.

VI

Njerëzit punues e qytetarët dhe kombet e kombësitë e Kosovës, bashkë me kombet e kombësitë e tjera, me njerëzit punues dhe qytetarët e Republikës Socialiste të Serbisë dhe të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të vendosur që të gjitha forcat e veta t'i drejtojnë kah puna krijuese në paqë dhe ndërtimin e bashkësisë së tyre socialiste vetëqeverisëse, zbatojnë në mënyrë konsekuente politikën e paqes, e kundër agresionit, luftës dhe presioneve agresive të çfarëdo lloji. Për të siguruar zhvillimin e vet paqësor dhe ndërtimin socialist, ata janë të vendosur që me të gjitha forcat dhe mjetet në dispozicion, me luftë të armatosur dhe me forma të tjera të rezistencës së përgjithshme popullore, të mbrojnë lirinë, pavarësinë, sovranitetin e vet, tërësinë territoriale dhe rendin socialist vetëqeverisës. Për këtë qëllim njerëzit punues e qytetarët dhe kombet e kombësitë organizojnë dhe ndërtojnë mbrojtjen e përgjithshme popullore si pjesë të pandarë të rregullimit shoqëror socialist vetëqeverisës, të vetëdijshëm se aftësia mbrojtëse e shoqërisë dhe prega-

titja e vendit për mbrojtje është më e madhe, kurse mundësia e agresionit më e vogël sa më e zhvilluar që të jetë mbrojtja e përgjithshme popullore si formë dhe përmbajtje e organizimit mbrojtës të bashkësisë shoqërore. Forcimi i aftësisë mbrojtëse të vendit është pjesë përbërëse e politikës së paqes dhe bashkëpunimit të barabartë ndërkombëtar.

Mbrojtja e përgjithshme popullore është sistem unik i organizimit, përgatitjes dhe pjesëmarrjes së të gjitha bashkësive shoqërore-politike, bashkësive lokale, organizatave të punës së bashkuar, bashkësive vetëqeverisëse të interesit dhe organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse, organizatave shoqërore-politike e organizatave të tjera shoqërore, njerëzve punuese dhe qytetarëve në luftën e armatosur dhe në të gjitha format e tjera të rezistencës dhe në kryerjen e detyrave të tjera me interes për mbrojtjen e vendit.

VII

Lidhja e Komunistëve të Kosovës si pjesë e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë — iniciatore dhe organizatore të Luftës nacionalçlirimtare dhe të revolucionit socialist, është bartëse e aspiratave dhe interesave të klasës punëtore dhe forcë e organizuar prise ideore e politike e klasës punëtore dhe e të gjithë njerëzve punues të Kosovës në ndërtimin e socializmit, në sigurimin e barazisë kombëtare dhe forcimin e vëllazërimit e bashkimit të kombeve e të kombësive dhe në realizimin e solidaritetit të njerëzve punues.

Lidhja e Komunistëve të Kosovës me rolin pris ideo-politik dhe me veprimtarinë e vet në kushtet e demokracisë socialiste vetëqeverisëse, është iniciatore dhe bartëse kryesore e aktivitetit ideo-politik për mbrojtjen e fryteve dhe zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist, ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse, realizimin e rolit vendimtar të klasës punëtore dhe forcimin e vetëdijes socialiste vetëqeverisëse demokratike dhe përgjigjet për këtë.

Lidhja Socialiste e Popullit Punues, e krijuar në Luftën nacionalçlirimtare dhe në revolucionin socialist si front vullnetar e demokratik i njerëzve punues e i qytetarëve dhe i të gjitha forcave të organizuara socialiste me Partinë Komuniste në krye, dhe e ndërtuar më tutje në kushtet e zhvillimit të shoqërisë socialiste vetëqeverisëse, është bazë më e gjerë e aktivitetit të tyre shoqëror-politik në sistemin socialist vetëqeverisës.

Në Lidhjen Socialiste të Popullit Punues njerëzit punues dhe qytetarët, Lidhja e Komunistëve si forcë prise ideore e politike, organizatat e tjera shoqërore-politike dhe të gjitha forcat e organizuara socialiste realizojnë unitetin politik e të aksionit të forcave socialiste dhe orientojnë zhvillimin shoqëror mbi bazat e pushtetit e të vetëqeverisjes së klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues, dhe për këtë qëllim:

shqyrtojnë çështjet shoqërore dhe marrin iniciativë politike në të gjitha lëmët e jetës shoqërore, harmonizojnë mendimet, përcaktojnë qëndrimet politike sa i përket zgjidhjes së këtyre çështjeve, orientimit të zhvillimit shoqëror, realizimit të të drejtave dhe interesave të njerëzve punues e të qytetarëve, realizimit të barazisë së kombeve e të kombësive dhe përparimit të marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse demokratike, bëjnë propozime për zgjidhjen e çështjeve shoqërore dhe u japin orientime delegatëve të vet në kuvendet e bashkësive shoqërore-politike;

përcaktojnë programet e përbashkëta të aktivitetit shoqëror dhe kriteret e përbashkëta për zgjedhjen e delegacioneve në organizatat themelore të punës së bashkuar, bashkësi lokale dhe organizata e bashkësi të tjera vetëqeverisëse dhe për zgjedhjen e delegatëve në kuvendet e bashkësive shoqërore-politike; sigurojnë propozimin dhe caktimin demokratik të kandidatëve për anëtarë të delegacioneve në organizatat dhe bashkësitë vetëqeverisëse, kandidatëve për delegatë në kuvendet e bashkësive shoqërore-politike dhe kandidatëve për ushtrimin e funksioneve vetëqeverisëse, publike e të funksioneve të tjera shoqërore në bashkësitë shoqërore-politike, shqyrtojnë

çështjet e përgjithshme të politikës së kuadrave e të ngritjes së kuadrove dhe përcaktojnë kriteret për zgjedhjen e kuadrove;

përcjellin punën e organeve të pushtetit e të organeve të qeverisjes, të organizatave e të bashkësive vetëqeverisëse dhe të bartësve të funksioneve vetëqeverisëse, publike e të funksioneve të tjera shoqërore, shfaqin mendimet e vlerësimet e veta dhe bëjnë kontrollin shoqëror e kritikën e punës së tyre, sidomos sa i përket sigurimit të publicitetit të punës dhe përgjegjësisë në punë;

krijojnë kushte për pjesëmarrjen e gjithanshme të rinisë dhe të organizatave të saj në jetën shoqërore dhe politike;

sigurojnë informimin e njerëzve punues e të qytetarëve dhe ndikimin e vet në sistemin shoqëror të informimit dhe në realizimin e rolit të shtypit e të formave të tjera të informimit e të komunikimit publik;

luftojnë për marrëdhënje humane midis njerëzve, për zhvillimin e vetëdijes socialiste demokratike dhe të normave të jetës socialiste, si dhe për mënjanimin e dukurive që pengojnë zhvillimin e marrëdhënjeve shoqërore socialiste vetëqeverisëse demokratike ose që në çfarëdo mënyrë u sjellin dëm.

Bashkësitë shoqërore-politike, në kuadër të të drejtave dhe detyrave të veta, kanë për detyrë të sigurojnë kushtet materiale dhe kushtet e tjera për realizimin e funksioneve të Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të përcaktuara me Kushtetutë.

Punëtorët e organizuar vullnetarisht në sindikatë, si organizatë më të gjerë të klasës punëtore, luftojnë: për realizimin e pozitës së klasës punëtore të përcaktuar me kushtetutë; për realizimin e marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse dhe për rolin vendimtar të punëtorëve në drejtimin e riprodhimit shoqëror; për realizimin e interesave dhe të drejtave vetëqeverisëse e të drejtave të tjera të punëtorëve në të gjitha lëmët e punës e të jetës, për sigurimin e barazisë së punëtorëve në bashkimin e punës e të mjeteve, fitimin e ndarjen e të ardhurave dhe për caktimin e kriterëve të përbashkëta për ndarje sipas rezultateve të punës; për ndërlidhjen dhe integrimin

vetëqeverisës të lëmëve të ndryshme të punës shoqërore; për zhvillimin e forcave prodhuese të shoqërisë dhe ngritjen e produktivitetit të punës; për harmonizimin vetëqeverisës të interesave individuale, të përbashkëta e të përgjithshme shoqërore; për ngritjen e arësimit të punëtorëve dhe aftësimin e punëtorëve për ushtrimin e funksioneve vetëqeverisëse dhe funksioneve të tjera shoqërore; për propozimin dhe caktimin demokratik të kandidatëve për delegatë në organet e qeverisjes në organizatat e punës së bashkuar dhe në organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse dhe kandidatëve për delegacione në këto organizata e bashkësi dhe për delegatë në kuvendet e bashkësive shoqërore-politike; për pjesëmarrjen më të gjerë të punëtorëve në ushtrimin e funksioneve të pushtetit e të drejtimit të punëve të tjera shoqërore; për realizimin e interesave të klasës punëtore në politikën e kuadrove; për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve; për sigurimin e sigurisë sociale dhe zhvillimin e standardit jetësor të punëtorëve, si dhe për zhvillimin e forcimin e solidaritetit dhe ngritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë klasore të vetëqeverisësve.

Sindikata merr iniciativë për marrëveshje vetëqeverisëse dhe marrëveshje shoqërore, merr pjesë drejtpërdrejtë në këto marrëveshje vetëqeverisëse e marrëveshje shoqërore dhe u jep propozime organeve të qeverisjes të organizatave e të bashkësive vetëqeverisëse, kuvendeve të bashkësive shoqërore-politike dhe organeve të tjera shtetërore e shoqërore për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me pozitën materiale dhe shoqërore të klasës punëtore.

VIII

Duke u nisur nga bindja se bashkëjetesa paqësore dhe bashkëpunimi aktiv i shteteve e i popujve të barabartë, pa marrë parasysh diferencat në rregullimin shoqëror të tyre, janë kusht i domosdoshëm i paqes dhe i përparimit shoqëror në botë dhe nga parimet e aprovuara në të cilat Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë bazon marrëdhënjet e veta

ndërkombëtare, Krahina Socialiste Autonome e Kosovës në kuadër të politikës së jashtme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të traktateve ndërkombëtare realizon bashkëpunimin dhe zhvillon marrëdhënjet me organet e organizatat e shteteve të tjera dhe me organet e organizatat ndërkombëtare.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës merr pjesë me republikat socialiste dhe me Krahinën Socialiste Autonome të Vojvodinës në përcaktimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të marrëdhënjëve të saj me shtetet e tjera, me organizatat ndërshtetërore e ndërkombëtare.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës nxit bashkëpunimin e komunave, organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave të tjera vetëqeverisëse në territorin e vet me njësitë territoriale, organizatat dhe organet përkatëse në shtetet e tjera.

IX

Sistemi shoqëror-ekonomik e sistemi politik dhe marrëdhënjet e tjera të përcaktuara me kushtetutë janë të orientuara në zgjerimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë socialiste, për përballimin e kundërthënjeve të saj dhe për përparimin e tillë shoqëror, i cili, në bazë të zhvillimit të gjithanshëm të forcave prodhuese, produktivitetit të lartë të punës, begatisë së prodhimeve dhe zhvillimit të gjithanshëm të njeriut si personalitet i lirë do të bëjë të mundur që të zhvillohen marrëdhënje të tilla shoqërore në të cilat do të realizohet parimi i komunizmit: „Secili sipas aftësive — secilit sipas nevojave”.

Për këtë qëllim organet e vetëqeverisjes, organet shtetërore, organizatat dhe bashkësitë vetëqeverisëse, organizatat shoqërore-politike dhe organizatat e tjera, njerëzit punues dhe qytetarët drejtpërdrejt — kanë për detyrë që me tërë veprimtarinë e vet:

të zgjerojnë e të forcojnë bazën materiale të shoqërisë e të jetës së individëve me zhvillimin e forcave prodhuese, ngritjen e produktivitetit të punës dhe

me përparimin e vazhdueshëm të marrëdhënjeve socialiste vetëqeverisëse;

të krijojnë kushte në të cilat do të eliminohen diferencat shoqërore-ekonomike midis punës mendore e punës fizike dhe në të cilat puna e njeriut do të bëhet shprehje gjithnjë e më e plotë e krijimtarisë dhe e personalitetit të njeriut;

të zgjerojnë e të zhvillojnë të gjitha format e vetëqeverisjes dhe të demokratizmit socialist vetëqeverisës, e sidomos në lëmët ku mbizotërojnë funksionet e pushtetit politik, të kufizojnë dhunën e të krijojnë kushte për zhdukjen e saj dhe të ndërtojnë midis njerëzve marrëdhënje të bazuara në vetëdijen për interesat e përbashkëta, në etikën socialiste dhe në krijimtarinë e lirë të njeriut;

të thellojnë barazinë kombëtare dhe vëllazërimin e bashkimin midis kombeve e kombësive;

të kontribuojnë për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, humanizimin e ambientit shoqëror e të personalitetit të njeriut, forcimin e solidaritetit e të humanitetit midis njerëzve dhe respektimin e dinjitetit njerëzor;

të zhvillojnë bashkëpunimin e gjithanshëm dhe afrimin me të gjithë popujt, në pajtim me aspiratat progresive të njerëzimit.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës krijon kushte për zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik, politik, social e kultural të kombeve e të kombësive të Kosovës.

Për barazimin e kushteve materiale të jetës e të punës shoqërore të njerëzve punues dhe për zhvillimin sa më të harmonizuar të ekonomisë së Kosovës si tërësi, i kushtohet kujdes i veçantë zhvillimit më të shpejtë dhe më proporcional të viseve jomjaft të zhvilluara dhe për këtë qëllim sigurohen mjete të nevojshme dhe merren masa të tjera.

X

Duke i shprehur parimet themelore të shoqërisë socialiste vetëqeverisëse dhe të përparimit të saj, kjo pjesë e Kushtetutës është bazë dhe drejtëm për interpretimin e Kushtetutës e të ligjeve, si dhe për veprimin e të gjithëve e të secilit.

PJESA E PARË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës është bashkësi autonome socialiste shoqërore-politike demokratike dhe vetëqeverisëse e njerëzve punues dhe qytetarëve, e malazezëve, muslimanëve, serbëve, shqiptarëve, turqëve dhe pjesëtarëve të kombeve e të kombësive të tjera dhe të grupeve etnike të barabarta, e bazuar në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punues.

Krahina Socialiste Autonome e Kosovës është në kuadër të Republikës Socialiste të Serbisë dhe të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 2

Njerëzit punues e qytetarët, kombet e kombësitë e Kosovës, realizojnë të drejtat sovrane në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, e kur kjo është në interes të përbashkët të njerëzve punues, të kombeve e të kombësive të Republikës si tërësi e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë edhe në Republikë, dhe në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, kur kjo është përcaktuar në interes të përbashkët me Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Neni 3

Territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e përbëjnë territoret e komunave të tanishme.

Territori i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e Kuvendit krahinor.

Neni 4

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës kombet e kombësitë janë të barabarta dhe kanë të drejta e detyra të njejta.

Për realizimin e barazisë së kombeve e të kombësive garantohet e drejta e zhvillimit të lirë të tyre dhe e të shprehurit të lirë të veçorive kombëtare, të gjuhës, të kulturës, të historisë dhe të simboleve të tjera.

Neni 5

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës sigurohet barazia e gjuhës shqipe, serbokroate e turke dhe e shkrimeve të tyre.

Me këtë Kushtetutë dhe me ligjin krahinor rregullohet dhe sigurohet aplikimi i këtij parimi.

Neni 6

Në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës është e drejtë e pjesëtarëve të të gjitha kombeve e kombësive që të përdorin flamurin e vet kombëtar.

Kushtet dhe mënyra e përdorimit të flamurit kombëtar rregullohen me ligj.

Neni 7

Kryeqyteti i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës është Prishtina.

PJESA E DYTË

RREGULLIMI SHOQËROR

K r e u I

RREGULLIMI SHOQËROR-EKONOMIK

1. Pozita e njeriut në punën e bashkuar dhe pronësia shoqërore

Neni 8

Rregulimi shoqëror-ekonomik socialist në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës, në kuadër të rregullimit unik shoqëror-ekonomik të RSFJ, bazohet në punën e lirë të bashkuar me mjetet e prodhimit në pronësinë shoqërore dhe në vetëqeverisjen e punëtorëve në prodhim dhe në ndarjen e produktit shoqëror në organizatat themelore e organizatat e tjera të punës së bashkuar dhe në riprodhimin shoqëror në tërësi.

Neni 9

Puna dhe rezultatet e punës caktojnë pozitën materiale e shoqërore të njeriut në bazë të të drejtave dhe përgjegjësisive të barabarta.

Askush nuk mund të realizojë as në mënyrë të drejtpërdrejtë as të tërthortë përfitime materiale dhe përfitime të tjera me shfrytëzimin e punës së huaj.

Askush nuk guxon në asnjë mënyrë të pengojë as të kufizojë punëtorin që në mënyrë të barabartë me punëtorët e tjerë të vendosë mbi punën e vet, dhe mbi kushtet e rezultatet e punës së vet.

Neni 10

Mjetet e prodhimit dhe mjetet e tjera të punës së bashkuar, produktet e punës së bashkuar dhe të ardhurat e realizuara me punën e bashkuar, mjetet për plotësimin e nevojave të përbashkëta e të përgjithshme shoqërore, begatitë e natyrës dhe të mirat në përdorim të përgjithshëm janë pronë shoqërore.

Askush nuk mund të fitojë të drejtën e pronësisë mbi mjetet shoqërore që janë kusht i punës në organizatat themelore dhe organizatat e tjera të punës së bashkuar ose bazë materiale e realizimit të funksioneve të bashkësive vetëqeverisëse të interesit ose të organizatave e të bashkësive të tjera vetëqeverisëse dhe të bashkësive shoqërore-politike.

Mjetet shoqërore nuk mund të përdoren për përvetësimin e mbipunës së huaj, as për krijimin e kushteve për përvetësim të këtillë.

Neni 11

Punëtori në punën e bashkuar me mjetet në pronësinë shoqërore ka të drejtë pune me mjetet shoqërore si të drejtë të vet të patjetërsueshme që të punojë me këto mjete për të plotësuar nevojat e veta personale e shoqërore dhe që, si i lirë e i barabartë me punëtorët e tjerë në punën e bashkuar, të drejtojë punën e vet dhe kushtet e rezultatet e punës së vet.

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë sa i përket disponimit, përdorimit dhe drejtimit të mjeteve shoqërore, rregullohen me kushtetutë dhe me ligj, në pajtim me natyrën dhe destinimin e këtyre mjeteve.

Neni 12

I garantohet çdo punëtori në punën e bashkuar me mjetet në pronësinë shoqërore që, duke realizuar të drejtën e punës me mjetet shoqërore, në organizatën themelore të punës së bashkuar në të cilën punon dhe në të gjitha format e tjera të bashkimit të punës e të mjeteve, së bashku dhe në mënyrë të barabartë me punëtorët e tjerë, të drejtojë punën dhe veprimtarinë e organizatës së punës së bashkuar dhe punët e mjetet në terësinë e marrëdhënjeve të rip-

roditimit shoqëror, të rregullojë marrëdhënjet reciproke në punë, të vendosë mbi të ardhurat që realizon në forma të ndryshme bashkimi të punës e të mjeteve dhe të fitojë të ardhura personale.

Organizata themelore e punës së bashkuar është formë themelore e punës së bashkuar në të cilën punëtorët në mënyrë të drejtpërdrejtë e të barabartë realizojnë të drejtat e veta shoqërore-ekonomike dhe të drejtat e tjera vetëqeverisëse dhe vendosin mbi çështjet e tjera të pozitës së tyre shoqërore-ekonomike.

Kundërkushtetues është çdo akt dhe veprim me të cilët cenohen këto të drejta të punëtorit.

Neni 13

Në realizimin e së drejtës së punës me mjetet shoqërore, punëtorët në punën e bashkuar janë përgjegjës reciprokisht që, në interes të tyre të përbashkët dhe në interes të përgjithshëm shoqëror, t'i përdorin këto mjete në mënyrë oportune në pikëpamje shoqërore e ekonomike dhe që, si bazë materiale të punës së vet dhe të punës së terësishme shoqërore, t'i përtrijnë, shtojnë e përparojnë vazhdimisht, si dhe t'i kryejnë me ndërgjegje obligimet e veta të punës.

Punëtorët në punën e bashkuar në realizimin e së drejtës së punës me mjetet shoqërore nuk mund të realizojnë përfitime materiale dhe përparësi të tjera që nuk bazohen në punën e tyre.

Neni 14

Punëtorët e organizatave të punës së bashkuar që ushtrojnë veprimtari në lëmët e arësimin, shkencës, kulturës, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe të veprimtarive të tjera shoqërore fitojnë të ardhura me këmbimin e lirë të punës së vet me punën e njerëzve punes nevojat dhe interesat e të cilëve i plotësojnë në këto lëmë.

Këmbimin e lirë të punës së vet punëtorët e këtyre organizatave të punës së bashkuar e realizojnë drejtpërdrejt me njerëzit punues nevojat dhe interesat e të cilëve i plotësojnë ose nëpërmjet organizatave të tyre të punës së bashkuar dhe bashkësive vetë-

qeverisëse të interesit, respektivisht në kuadër të bashkësive vetëqeverisëse të interesit.

Punëtorët e organizatave të punës së bashkuar të veprimtarive shoqërore me këmbimin e lirë të punës realizojnë pozitë të njejtë shoqërore-ekonomike sikurse punëtorët e organizatave të punës së bashkuar në veprimtaritë e tjera.

Sipas parimeve të këmbimit të lirë të punës fitojnë të ardhura edhe punëtorët e organizatave të punës së bashkuar në veprimtaritë e tjera në të cilat ndikimi i ligjshmërisë së tregut nuk mund të jetë bazë e harmonizimit të punës e të nevojave, as bazë e vlerësimit të rezultateve të punës.

Neni 15

Mbi të ardhurat e gjithmbarshme, si rezultat të punës së përbashkët të punëtorëve në organizatën themelore të punës së bashkuar dhe të punës së tërësishme shoqërore, të realizuara në forma të ndryshme të bashkimit të punës e të mjeteve në bazë të ndikimit të ligjshmërisë së tregut dhe mbi bazën vetëqeverisëse të kushteve shoqërisht të përcaktuara të fitimit të të ardhurave, punëtorët vendosin në organizatat themelore të punës së bashkuar në pajtim me të drejtat dhe përgjegjësitë e veta kushtetuese ndaj punëtorëve të tjerë në punën e bashkuar dhe ndaj bashkësisë shoqërore në tërësi.

Të ardhurat që i realizojnë së bashku me bashkimin e punës e të mjeteve, organizatat themelore të punës së bashkuar i ndajnë në tërësi midis tyre sipas kontributit të vet në realizimin e këtyre të ardhurave, e në bazë të kriterëve që i caktojnë me marrëveshjen vetëqeverisëse.

Të ardhurat e realizuara në organizatën themelore të punës së bashkuar përbëjnë bazën materiale të së drejtës së punëtorëve që të vendosin mbi kushtet e punës së vet dhe mbi ndarjen e të ardhurave dhe të fitojnë të ardhura personale.

Neni 16

Pjesa e të ardhurave që është rezultat i punës në kushte posaqërisht të volitshme natyrore ose që është

të rezultat i favoreve të jashtëzakonshme në treg ose i favoreve të tjera të jashtëzakonshme në fitimin e të ardhurave, përdoret, në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse dhe me ligj, për zhvillimin e organizatës së punës së bashkuar në të cilën është realizuar ose për zhvillimin e bazës materiale të punës së bashkuar në komunë dhe në Krahinë.

Drejtimi i pjesës së të ardhurave që shfrytëzohet për zhvillimin e bazës materiale të punës së bashkuar në komunë ose në Krahinë, mbështetet në baza të vetëqeverisjes.

Neni 17

Punëtorët në organizatën themelore të punës së bashkuar ndajnë të ardhurat për konsumin e vet personal e të përbashkët, për zgjerimin e bazës materiale të punës së bashkuar dhe për rezerva.

Punëtorët për konsumin e tërësishëm personal e të përbashkët ndajnë pjesën e të ardhurave në përpjestim me kontributin e tyre për realizimin e të ardhurave, që e kanë dhënë me punën e vet dhe me investimin e mjeteve shoqërore si punë të tejshkuar të punëtorëve.

Neni 18

Çdo punëtori, në pajtim me parimin e ndarjes sipas punës dhe me rritjen e produktivitetit të punës së tij e të punës së tërësishme shoqërore dhe me parimin e solidaritetit të punëtorëve në punën e bashkur, i takojnë nga të ardhurat e organizatës themelore të punës së bashkuar të ardhurat personale për plotësimin e nevojave të tij personale, të përbashkëta e të përgjithshme shoqërore, sipas rezultateve të punës së tij dhe kontributit personal të tij që e ka dhënë me punën e vet vijuese e të tejshkuar për shtimin e të ardhurave të organizatës themelore.

Neni 19

Punëtorët në organizatën themelore të punës së bashkuar përcaktojnë bazat dhe kriteret e ndarjes

së të ardhurave dhe bazat e kriteret e ndarjes së mjeteve për të ardhurat e veta personale.

Punëtorët në organizatën themelore të punës së bashkuar bashkë me punëtorët në organizatat e tjera të punës së bashkuar përcaktojnë bazat dhe kriteret e përbashkëta për ndarjen e të ardhurave dhe ndarjen e mjeteve për të ardhurat personale.

Në qoftë se me përndarjen e të ardhurave, respektivisht me ndarjen e mjeteve për të ardhurat personale shkelen marrëdhënjet që i përgjigjen parimit të ndarjes sipas punës ose çrregullohet procesi i riprodhimit shoqëror, me ligj mund të caktohen masat me të cilat sigurohet barazia e punëtorëve në aplikimin e parimit të ndarjes sipas punës, respektivisht me të cilat pengohen ose mënjanohen çrregullimet në riprodhimin shoqëror.

Neni 20

I garantohen çdo punëtori në punën e bashkuar me mjetet shoqërore të ardhurat personale dhe të drejtat e tjera në bazë të punës së paku në shumën, respektivisht vëllimin që sigurojnë sigurinë materiale e sociale të tij.

Shuma e të ardhurave personale të garantuara dhe vëllimi i të drejtave të tjera të garantuara, si dhe mënyra e realizimit të tyre përcaktohen me marrëveshjen vetëqeverisëse, marrëveshjen shoqërore dhe me ligj, varësisht nga shkalla e përgjithshme e produktivitetit të punës së tërësishme shoqërore dhe nga kushtet e përgjithshme të ambientit ku punon e jeton punëtori.

Neni 21

Me ligj mund të kufizohet përkohësisht disponimi nga ana e punëtorëve në organizatat themelore të punës së bashkuar i pjesës së mjeteve të riprodhimit shoqëror ose të përcaktohet obligimi i bashkimit të pjesës së këtyre mjeteve për financimin e nevojave të caktuara të domosdoshme të riprodhimit shoqëror, të përcaktuara me planin me afat të mesëm të zhvillimit të Krahinës. Me bashkimin e obligueshëm të

pjesës së mjeteve të riprodhimit shoqëror nuk mund të merren përherë të drejtat e punëtorëve të organizatës themelore të punës së bashkuar sa u përket këtyre mjeteve. Ligji për këte nxirret me shumicën prej dy të tretash të votave të të gjithë delegatëve të dhomës kompetente të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 22

Kur kjo është e domosdoshme për pengimin dhe menjanimin e çrregullimeve të mëdha në ekonomi ose kur këte e kërkojnë interesat e mbrojtjes popullore ose nevojat e tjera të jashtëzakonshme të Krahinës, me ligj mund të përcaktohen:

kufijt brenda të cilëve bashkësitë shoqërore-politike mund t'i përcaktojnë të ardhurat e veta nga të ardhurat e organizatave të punës së bashkuar dhe nga qarkullimi i prodhimeve e i shërbimeve;

obligimet e organizatave të punës së bashkuar, të bashkësive vetëqeverisëse të interesit dhe të organizatave e të bashkësive të tjera vetëqeverisëse dhe të bashkësive shoqërore-politike që të formojnë mjete shoqërore të rezervës;

ndalimi i përkohshëm i disponimit të pjesës së mjeteve shoqërore për konsum ose i pjesës së mjeteve shoqërore për financimin e riprodhimit të zgjeruar nga ana e organizatave të punës së bashkuar, bashkësive vetëqeverisëse të interesit dhe organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse si dhe bashkësive shoqërore-politike;

mënyrën e disponimit të tepricave të të ardhurave të buxheteve të bashkësive shoqërore-politike, si dhe tepricave të të ardhurave të bashkësive vetëqeverisëse të interesit që dalin nga obligimet e përcaktuara me ligj.

Ligji mbi masat që aplikohen për pengimin dhe menjanimin e çrregullimeve të mëdha në ekonomi ose kur këtë e kërkojnë interesat e mbrojtjes popullore ose nevojat e tjera të jashtëzakonshme të Krahinës, nxirret me shumicën e votave të të gjithë delegatëve të dhomës kompetente të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 23

Punëtorët në organizatat themelore të punës së bashkuar dhe njerëzit e tjerë punues, në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse dhe marrëveshjen shoqërore, ndajnë dhe bashkojnë mjete për ndërtimin e banesave, për përmirësimin e kushteve të banimit të punëtorëve dhe për shpërblimin e pjesës së qirasë së disa kategorive të shfrytëzuesve të banesave.

Me ligj mund të përcaktohet shkalla e ulët e ndarjes së mjeteve për ndërtimin e banesave dhe obligimet e organizatave të punës së bashkuar në territorin e komunës që, sipas parimeve të solidaritetit, të bashkojnë pjesën e këtyre mjeteve për krijimin e kushteve më të volitshme për ndërtimin e banesave për nevojat e kategorive të caktuara të njerëzve punues dhe për punëtorët në ato organizata të punës së bashkuar që nuk kanë mjete të nevojshme për këtë qëllim.

Mbi mënyrën e shfrytëzimit dhe disponimit e këtyre mjeteve, në pajtim me ligjin, vendosin punëtorët dhe njerëzit e tjerë punues që i kanë bashkuar mjetet.

Neni 24

Organizata e punës së bashkuar, respektivisht personi tjetër juridik-shoqëror përgjigjet për obligimet e veta me mjetet shoqërore që disponon.

Neni 25

Të drejtat e organizatës së punës së bashkuar dhe të personit tjetër juridik-shoqëror sa i përket pasurisë së paluejtshme dhe disa sendeve të luejtshme dhe të drejtat e tjera në pronësinë shoqërore, me një shpërblim përkatës dhe sipas procedurës së përcaktuar me ligj, mund të merren ose të kufizohen vetëm nëse këtë e kërkojnë nevojat e rregullimit me plan të hapësirës ose të ndërtimit të objekteve me rëndësi shoqërore të përcaktuara në bazë të ligjit ose interesi tjetër i përgjithshëm i caktuar me ligj.

Për të drejtat që i janë marrë lidhur me tokën ose begatitë e tjera të natyrës organizata e punës së bashkuar, respektivisht personi tjetër juridik-shoqëror, ka të drejtë shpërblimi vetëm për punën dhe mjetet e investuara në këtë tokë ose në begatinë tjetër të natyrës. Në qoftë se toka ose begatia tjetër e natyrës janë kushte të punës, organizata e punës së bashkuar, respektivisht personi tjetër juridik-shoqëror, ka të drejtë për shpërblim me të cilin sigurohet që këto kushte të mos keqësohen.

Neni 26

Punëtorëve të organizatës themelore të punës së bashkuar, e cila në veprimtarinë e vet përdorë mjetet e organizatave të tjera të punës së bashkuar që sipas kësaj baze kanë të drejtë të marrin pjesë në të ardhurat e realizuara bashkarisht, u sigurohen, në kuadër të të ardhurave të realizuara në këtë mënyrë, mjetet për konsumin e tyre personal e të përbashkët në pajtim me bazat dhe kriteret e përbashkëta që vlejné në organizatat e punës së bashkuar, si dhe mjetet për zgjerimin e bazës materiale të punës sipas kontributit të tyre në të ardhurat e realizuara bashkarisht.

Kriteret për përcaktimin e kontributit në të ardhurat e realizuara bashkarisht caktohen me marrëveshjen vetëqeverisëse, në pajtim me parimet unike mbi bashkimin e mjeteve të përcaktuara me ligjin federativ.

Organizatat e punës së bashkuar që bashkojnë mjetet, sipas kësaj baze nuk mund të fitojné të drejtën e pjesëmarrjes së përhershme në të ardhurat e organizatës së punës së bashkuar që i shfrytëzon këto mjete në veprimtarinë e vet.

E drejta e pjesëmarrjes në të ardhurat e realizuara bashkarisht në bazë të bashkimit të mjeteve shuhet kur organizatës së punës së bashkuar, përveç pjesëmarrjes përkatëse në të ardhurat e realizuara bashkarisht, i kthehen edhe mjetet me bashkimin e të cilave është fituar kjo e drejtë, respektivisht kur në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse, shuhet e drejta e kthimit të mjeteve të bashkuara.

Neni 27

Organizata e punës së bashkuar, në kushtet dhe kufijt e përcaktuar me ligjin federativ, mund të përdorë në veprimtarinë e vet mjetet e personave të huaj.

Punëtorët e organizatës së punës së bashkuar, e cila përdorë mjetet e investuara nga ana e personave të huaj, kanë të drejta të njejta shoqërore-ekonomike dhe të drejta të tjera vetëqeverisëse sikurse punëtorët e organizatave të punës së bashkuar që në veprimtarinë e vet përdorin mjetet e organizatave të tjera të punës së bashkuar në Krahinë.

Personi i huaj që ka investuar mjetet në organizatën e punës së bashkuar në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës mund të marrë pjesë në të ardhurat e kësaj organizate vetëm brenda kufijve dhe në kushtet e përcaktuara për marrëdhënjet reciproke të organizatave të punës së bashkuar në Krahinë.

Të drejtat e personit të huaj sa u përket mjeteve që ka investuar në organizatën e punës së bashkuar në Krahinë nuk mund të zvogëlohen me ligj ose me dispozitë tjetër pasi të jetë bërë e plotëfuqishme kontrata me të cilën janë përcaktuar këto të drejta.

Neni 28

Organizatave të punës së bashkuar, për të zgjeruar bazën materiale të punës, mund të mbledhin mjete në të holla të qytetarëve dhe, bashkë me kthimin e këtyre mjeteve t'u sigurojnë edhe shpërblimin për mjetet e investuara në formë kamate ose favoresh të tjera të caktuara në bazë të ligjit.

Neni 29

Punëtorët që në organizatën e punës së bashkuar kryejnë punë administrative-profesionale, ndihmëse dhe punë të ngjashme me interes të përbashkët për disa organizata në kuadër të saj dhe punëtorët që kryejnë punë të këtilla me kooperativën bujqësore ose kooperativën tjetër, si dhe punëtorët në organizatën e bashkimit afar, në bankë dhe në

bashkësinë e sigurimit, formojnë bashkësinë punuese. Punëtorët në bashkësinë e këtillë punuese mund të organizohen si organizatë e punës së bashkuar në kushtet e përcaktuara me ligj.

Punëtorët që në organizatën e punës së bashkuar kryejnë punë të tjera me interes të përbashkët për disa organizata në kuadër të saj, si dhe punëtorët që kryejnë punë të këtilla për kooperativën bujqësore ose kooperativën tjetër, formojnë bashkësinë punuese po që se nuk ekzistojnë kushtet e përcaktuara me kushtetutë që të organizohen si organizatë themelore e punës së bashkuar.

Punëtorët e këtyre bashkësive punuese kanë të drejtë për mjete për konsumin personal e të përbashkët në pajtim me parimin e ndarjes sipas punës dhe me bazat e kriteret e ndarjes që vlejnë në organizatat e punës së bashkuar, si dhe të drejtat të tjera vetëqeverisëse të punëtorëve në organizatat e punës së bashkuar, në pajtim me natyrën e punëve që kryejnë dhe me interesat e përbashkëta për të cilat janë formuar këto bashkësi punuese.

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë reciproke të punëtorëve të këtyre bashkësive punuese dhe të shfrytëzuesve të shërbimeve të tyre rregullohen me marrëveshjen vetëqeverisëse, kurse marrëdhënjet reciproke të punëtorëve në bashkësinë punuese rregullohen me aktet e tyre vetëqeverisëse në pajtim me këtë marrëveshje vetëqeverisëse.

Neni 30

Punëtorët në bashkësitë punuese që kryejnë punët për bashkësitë vetëqeverisëse të interesit dhe organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse dhe shoqatat e tyre, organizatat shoqërore-politike dhe organizatat e tjera shoqërore, shoqatat e qytetarëve dhe organet e bashkësive shoqërore-politike, kanë të drejtë për mjete për konsumin personal e të përbashkët në pajtim me parimin e ndarjes sipas punës dhe me bazat e kriteret shoqërisht të përcaktuara të ndarjes që vlejnë për organizatat e punës së bashkuar. Ata kanë edhe të drejta të tjera vetëqeverisëse në pajtim me natyrën e punëve që kryej-

në dhe me përgjegjësinë shoqërore e politike të organizatave, të bashkësive dhe të organeve për të cilat kryejnë punët — për realizimin e funksioneve dhe detyrave të tyre.

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë reciproke të punëtorëve të këtyre bashkësive dhe të organizatave punuese, të bashkësive e të organeve për të cilat kryejnë punët, rregullohen me marrëveshje vetëqeverisëse, respektivisht me kontratë, në pajtim me ligjin.

Në këto bashkësi punuese nuk mund të kalohen të drejtat, autorizimet dhe përgjegjësitë e organizatave, të bashkësive dhe të organeve për të cilat ato kryejnë punët.

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve në bashkësitë punuese të organeve të bashkësive shoqërore-politike rregullohen me ligj, e kur këtë e lejon natyra e veprimtarisë së organeve — edhe me marrëveshjen vetëqeverisëse, respektivisht me kontratën e bashkësisë punuese dhe të këtyre organeve, dhe me aktet vetëqeverisëse të bashkësisë punuese.

Neni 31

Njerëzit punues që me punë personale ushtrojnë në mënyrë të pavarur si profesion veprimtarinë artistike ose veprimtarinë tjetër kulture, të avokatisë ose veprimtarinë tjetër profesionale kanë parimisht pozitë të njejtë shoqërore-ekonomike dhe në esencë të drejta e obligime të njejtë sikurse punëtorët në organizatat e punës së bashkuar.

Njerëzit punues që ushtrojnë ndonjë nga këto veprimtari mund të bashkojnë punën e vet dhe të formojnë bashkësi punuese të përkohshme ose të përhershme, të cilat në esencë kanë pozitë të njejtë sikurse organizatat e punës së bashkuar dhe në të cilat njerëzit punues në esencë kanë të drejta e detyra të njejtë sikurse punëtorët në organizatat e punës së bashkuar.

Me ligj caktohen kushtet në të cilat këta njerëz punues dhe bashkësitë e tyre punuese realizojnë të drejtat dhe përmbushin obligimet e veta, si dhe kushtet në të cilat ata në ushtrimin e këtyre veprim-

tarive mund t'i shfrytëzojnë mjetet shoqërore dhe t'i drejtojnë ato. Me ligj caktohet edhe mënyra e realizimit të bashkëpunimit të këtyre njerëzve punues me organizatat e punës së bashkuar, si dhe mënyra e pjesëmarrjes së tyre në krijimin e kushteve të punës në këto organizata dhe në disponimin e rezultateve të punës së vet të shprehura në të ardhurat e realizuara bashkarisht.

Neni 32

Punëtorët e organizatave të punës së bashkuar, në pajtim me parimin e reciprocitetit e të solidaritetit, bashkarisht dhe në mënyrë të barabrtë sigurojnë përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetës së punëtorëve me ndarjen dhe bashkimin e mjeteve për këtë qëllim dhe në mënyrë tjetër.

Organizatave të punës së bashkuar dhe bashkësitë shoqërore-politike kanë për detyrë që në pajtim me parimin e reciprocitetit e të solidaritetit t'u japin ndihmë ekonomike dhe ndihmë tjetër organizatave të punës së bashkuar që bien në vështirësi të jashtëzakonshme ekonomike dhe të marrin masa për sanimin e tyre po qe se kjo është në interes të përbashkët të organizatave të punës së bashkuar, respektivisht në interes shoqëror.

Organizata e punës së bashkuar, vetë ose në marrëveshje me organizatat e tjera të punës së bashkuar, në pajtim me parimet e reciprocitetit e të solidaritetit, siguron mjetet për inkadrimin në punë, rikualifikimin dhe realizimin e të drejtave të fituara të punëtorëve, po qe se nuk ka më nevojë për punën e tyre në organizatën e punës së bashkuar apo nëse organizata në kuadër të saj pushon së punuari.

Punëtori, përderisa nuk i sigurohet vendi tjetër i punës që u përgjigjet aftësive dhe kualifikimeve të tij, nuk mund të humbë cilësinë e punëtorit në organizatën themelore të punës së bashkuar, nëse për shkak të përparimit teknologjik ose përparimit tjetër që i kontribuojnë rritjes së produktivitetit të punës dhe suksesit më të madh të organizatës nuk ka më nevojë për punën e tij në këtë organizatë.

Me ligj mund të caktohet obligimi i bashkimit të mjeteve për këto qëllime dhe për inkuadrimin në punë në përgjithësi, si dhe të përcaktohen kushtet e përdorimit të këtyre mjeteve.

2. Bashkimi i punës dhe i mjeteve të riprodhimit shoqëror

Neni 33

Punën dhe mjetet e veta të riprodhimit shoqëpor në organizatat themelore të punës së bashkuar punëtorët i bashkojnë lirisht në organizatat punuese dhe në forma të tjera bashkimi të punës e të mjeteve.

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë reciproke në format e ndryshme të bashkimit të punës e të mjeteve, punëtorët në organizatat themelore të punës së bashkuar i rregullojnë me marrëveshjen vetëqeverisëse në pajtim me ligjin, duke siguruar në tërësinë e këtyre marrëdhënjeve të drejtat e punëtorëve të garantuara me Kushtetutë.

Neni 34

Organizata punuese është organizatë e pavarur vetëqeverisëse e punëtorëve të lidhur me interesa të përbashkëta në punë dhe të organizuar në organizatat themelore të punës së bashkuar në kuadër të saj, ose të lidhur drejtpërdrejt me procesin unik të punës.

Organizatën punuese mund ta themelojnë organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, bashkësitë lokale, bashkësitë shoqërore-politike dhe personat e tjerë juridikë-shoqërorë.

Organizatën punuese në kushtet dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj mund ta themelojnë njerëzit punues për të realizuar të drejtën për punë ose për t'i plotësuar nevojat me prodhime dhe shërbime të organizatës që e themelojnë. Organizatën punuese, në pajtim me ligjin, mund ta themelojnë edhe personat juridikë-civilë.

Njerëzit punues, respektivisht personat juridikë-civilë që depozitojnë mjetet e veta në organizatën e punës së bashkuar që e kanë themeluar, mund të kenë ndaj kësaj organizate në bazë të këtyre mjeteve, vetëm të drejtat që kanë qytetarët nga të cilët organizatat e punës së bashkuar mbledhin mjete për zgjerimin e bazës materiale të punës së vet.

Me ligj mund të përcaktohet që njerëzit punues dhe personat juridikë-civilë të mos mund të themelojnë organizata punuese për ushtrimin e veprimtarive të caktuara.

Organizatat punuese kanë pozitë të njejtë e punëtorët në to të drejta e përgjegjësi të njëjta shoqërore-ekonomike dhe të drejta e përgjegjësi të tjera vetëqeverisëse, pa marrë parasysh se kush e ka themeluar organizatën punuese.

Neni 35

Punëtorët në pjesën e organizatës punuese që përbën një tërësi pune, në të cilën rezultati i punës së tyre të përbashkët mund të shprehet pavarësisht si vlerë në organizatën punuese ose në treg dhe në të cilën punëtorët mund të realizojnë të drejtat e veta shoqërore-ekonomike dhe të drejtat e tjera vetëqeverisëse, kanë të drejtë dhe për detyrë që pjesën e këtyre të organizatës punuese ta organizojnë si organizatë themelore të punës së bashkuar.

Punëtorët në organizatën punuese në të cilën nuk ekzistojnë kushtet që disa pjesë të saj të organizohen si organizata themelore, realizojnë në organizatën punuese të gjitha të drejtat që i kanë punëtorët në organizatën themelore të punës së bashkuar.

Marrëdhënjet shoqërore-ekonomike dhe marrëdhënjet e tjera vetëqeverisëse në organizatën themelore të punës së bashkuar rregullohen me statutin dhe aktet e tjera vetëqeverisëse të saj në pajtim me kushtetutën dhe ligjin.

Në qoftë se me rastin e organizimit të organizatës themelore të punës së bashkuar është filluar konflikti, gjer në përfundimin e konfliktit, kundërvullnetit të punëtorëve që kanë marrë vendim për

organizimin e organizatës themelore, nuk mund të ndryshohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë që i kanë pasur gjer në ditën e marrjes së vendimit rreth të cilit zhvillohet konflikti.

Neni 36

Punëtorët kanë të drejtë që organizatën themelore të punës së bashkuar në të cilën punojnë ta shkëpusin nga gjiri i organizatës punuese.

Organizata themelore e punës së bashkuar që shkëputet ka për detyrë që, në marrëveshje me organizatat e tjera themelore të punës së bashkuar dhe me organizatën punuese si tërësi, të rregullojë mënyrën dhe kushtet e kryerjes së obligimeve që i ka marrë përsipër ndaj tyre gjer në kohën e shkëputjes dhe të shpërblejë dëmin që është shkaktuar me shkëputjen.

Punëtorët nuk mund ta shkëpusin organizatën e vet themelore të punës së bashkuar nga gjiri i organizatës punuese po qe se kjo, në kundërshtim me interesin e përgjithshëm, do të vështirësonte esencialisht ose do ta bënte të pamundur punën në organizatat e tjera themelore në kuadër të organizatës punuese respektivisht në organizatën punuese si tërësi.

Neni 37

Organizatat punuese mund të bashkohen në forma të ndryshme organizatash të përbëra të punës së bashkuar, e organizatat themelore të punës së bashkuar dhe organizatat punuese në bashkësi dhe forma të tjera bashkimi të organizatave të punës së bashkuar në të cilat realizojnë interesa të caktuara të përbashkëta.

Me ligj ose me vendim të kuvendit të bashkësisë shoqërore-politike të bazuar në ligj, në kushte të caktuara me kushtetutë, mund të përcaktohet bashkimi i obligueshëm i llojeve të caktuara të organizatave të punës së bashkuar në bashkësi në të cilat, në interes të përgjithshëm, sigurohet uniteti i sistemit të punës në lëmët përkatëse.

Neni 38

Organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit dhe personat e tjerë juridikë-shoqërorë me marrëveshje vetëqeverisëse mund të themelojnë bankën si organizatë të veçant për kryerjen e punëve të kredive e punëve të tjera bankare dhe në të, bashkë me personat e tjerë, t'i bashkojnë mjetet për realizimin e interesave të përbashkëta në sigurimin e mjeteve monetare për ushtrimin, zgjerimin dhe përparimin e veprimtarive të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave e të bashkësive të tjera vetëqeverisëse dhe për realizimin e interesave të tjera të përbashkëta.

Personat juridikë-shoqërorë me mjetet e të cilëve punon banka, drejtojnë veprimtarinë e bankës. Mjetet që realizon banka, pasi të paguhen shpenzimet e veprimtarisë dhe të ndahen mjetet për bashkësinë punuese të bankës, i ndajnë këta persona juridikë-shoqërorë midis tyre.

Personat juridikë-shoqërorë kanë të drejtë të drejtojnë punët e caktuara të bankës në njësinë e bankës që punon me mjetet e tyre.

Bashkësia shoqërore-politike nuk mund të jetë themeluese e bankës as t'i drejtojë punët e bankës.

Marrëdhënjet reciproke të personave juridikë-shoqërorë me mjetet e të cilëve punon banka, qeverisja e bankës dhe veprimtaria e bankës, rregullohen me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi themelimin e bankës, me statutin e saj dhe me ligj.

Neni 39

Veprimtaria e organizatave financiare që themelohen për mbledhjen e depozitave të kursimit dhe qeverisja e këtyre organizatave, si dhe veprimtaria e bankave që ka të bëjë me mbledhjen e depozitave të kursimit, rregullohen me ligj, në pajtim me parimet unike të sistemit kreditor.

Të drejtat e qytetarëve që në bazë të depozitave të kursimit të marit pjesë në drejtimin e veprimtarisë së këtyre organizatave financiare dhe që, përveç kamatave të kontraktuara, të fitojnë edhe favore të tjera të caktuara, rregullohen me ligj.

Neni 40

Në organizatat e punës së bashkuar që, përveç veprimtarive të tjera, merren edhe me veprimtari bankare ose të ngjashme, organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit dhe personat e tjerë juridikë-shoqërorë lidhur me këtë veprimtari kanë parimisht të drejta të njëjta me ato që kanë në bankë personat juridikë-shoqërorë me mjetet e të cilëve punon banka.

Në qoftë se në organizatat e punës së bashkuar organizohet veprimtaria e brendshme bankare ose veprimtaria e ngjashme, në veprimtarinë e këtillë aplikohen parimet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e bankave.

Neni 41

Organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, bashkësitë shoqërore-politike dhe personat e tjerë juridikë shoqëror me marrëveshje vetëqeverisëse mund të themelojnë bashkësinë e sigurimit të pasurisë e të personave nga llojet e njëjta, respektivisht të ngjashme të rreziqeve, respektivisht të dëmeve, ose nga disa lloje të ndryshme të rreziqeve respektivisht të dëmeve, dhe në të, bashkë me personat e tjerë, sipas parimeve të reciprocitetit e të solidaritetit, t'i bashkojnë mjetet për sigurimin e pasurisë e të personave dhe për menjanimin ose zvogëlimin e veprimit të pavolitshëm të shkaqeve që mund t'i sjellin këto dëme.

Në bashkësinë e sigurimit në të cilën bashkohen mjetet për sigurimin e pasurisë ose të personave nga disa lloje të ndryshme të rreziqeve respektivisht të dëmeve, të siguruarit që i bashkojnë mjetet për t'u siguruar nga llojet e njëjta ose të ngjashme të rreziqeve, respektivisht të dëmeve formojnë bashkësi të veçanta rreziku dhe bashkojnë mjetet në fonde të veçanta sigurimi për këto dëme. Të siguruarit në bashkësitë e rrezikut në marrëveshje me të siguruarit e tjerë në të njëjtën bashkësi të sigurimit përcaktojnë se në çfarë kushtesh mjetet e fondeve të destinuara për përmbushjen e obligimeve për një

lloj të dëmeve mund të përdoren për përmbushjen e obligimeve për llojet e tjera të dëmeve.

Personat juridikë-shoqërorë që bashkojnë mjetet në bashkësinë e sigurimit, respektivisht në bashkësinë e rrezikut, drejtojnë veprimtarinë e këtyre bashkësive.

Marrëdhënjet reciproke të personave juridikë-shoqërorë që i bashkojnë mjetet në bashkësinë e sigurimit, qeverisja e kësaj bashkësie dhe veprimtaria e saj rregullohen me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi themelimin e bashkësisë, me statutin ose aktin tjetër vetëqeverisës të saj dhe me ligj.

Qytetarët dhe personat juridikë-civilë — të siguruarit marrin pjesë në qeverisjen e bashkësisë së sigurimit, respektivisht të bashkësisë së rrezikut dhe realizojnë në to të drejtë të tjera në pajtim me statutin e bashkësisë së sigurimit dhe me ligjin.

Neni 42

Marrëdhënjet midis organizatave të punës së bashkuar që merren me punët e qarkullimit të mallrave e të shërbimeve dhe organizatave prodhuese e organizatave të tjera me të cilat punojnë, bazohen në parimet e bashkëpunimit e të bashkimit vetëqeverisës të punës dhe të mjeteve në kuadër të këtij bashkëpunimi. Këto organizata, sipas parimeve të barazisë, realizojnë ndikimin reciprok në politikën e veprimtarisë e të zhvillimit, marrin përsipër rrezikun e përbashkët, sigurojnë përgjegjësinë e përbashkët për zgjerimin e bazës materiale dhe për rritjen e produktivitetit të punës në prodhim e qarkullim, dhe marrin pjesë në të ardhurat e realizuara me këtë bashkëpunim sipas kontributit në realizimin e këtyre të ardhurave.

Organizatat e punës së bashkuar që kryejnë punët e eksportit e të importit organizohen dhe punojnë sipas parimeve të bashkëpunimit të obligueshëm me organizatat prodhuese dhe organizatat e tjera të punës së bashkuar për të cilat kryejnë eksportin ose importin, dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi përcaktojnë politikën e përbashkët të prodhimit, respektivisht të veprimtarisë tjetër, dhe po-

litikën e eksportit e të importit, bëjnë përndarjen e të ardhurave të realizuara me këtë bashkëpunim si të ardhura të përbashkëta, mbajnë së bashku rrezikun e kësaj veprimtarie dhe përgjegjësinë për përparimin e prodhimit e të qarkullimit, në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse ose me kontratën mbi këtë bashkëpunim.

Me ligj federativ rregullohet se në çfarë rastesh dhe në çfarë kushtesh organizatat e punës së bashkuar që merren me punët e eksportit e të importit, me punët e qarkullimit të mallrave me shumicë dhe me punët e tjera të qarkullimit të mallrave e të shërbimeve të caktuara me ligj, bashkojnë medoemos punën dhe mjetet me organizatat prodhuese dhe organizatat e tjera të punës së bashkuar me të cilat punojnë. Me ligj federativ rregullohet edhe mënyra dhe forma e bashkimit të punës e të mjeteve, mënyra e vendosjes mbi veprimtarinë e përbashkët, marrja përsipër bashkarisht e rrezikut dhe përcaktohen parimet e ndarjes së të ardhurave të realizuara bashkarisht.

Organizatat e punës së bashkuar që merren me punët e qarkullimit të mallrave e të shërbimeve për konsum të drejtpërdrejtë kanë për detyrë që, në mënyrën e caktuar me ligj, të bashkëpunojnë dhe të merren vesh me bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, bashkësitë lokale dhe me bashkësitë e organizatat e tjera të konsumuesve për punët me interes të përbashkët.

Neni 43

Organizata e punës së bashkuar mund të ushtrojë veprimtarinë dhe të investojë mjetet e riprodhimit shoqëror në botën e jashtme, në kushtet dhe kufijt që janë përcaktuar me ligjin federativ.

Të drejtat dhe mjetet që organizata e punës së bashkuar i fiton në çfarëdo baze në botën e jashtme janë pjesë përbërëse e mjeteve shoqërore që i drejtojnë punëtorët e kësaj organizate.

Në organizatën e punës së bashkuar që ushtron veprimtarinë në botën e jashtme, punëtorët vendet e punës së të cilëve janë në botën e jashtme kanë

të drejta, obligime dhe përgjegjësi të njëjta sikurse punëtorët e kësaj organizate në Krahinë.

Neni 44

Organizatat themelore dhe organizatat e tjera të punës së bashkuar, bashkësitë e tyre dhe format e tjera të bashkimit të organizatave të punës së bashkuar, bankat, bashkësitë e sigurimit të pasurisë e të personave dhe organizatat e tjera financiare janë persona juridikë me të drejta, obligime dhe përgjegjësi që i kanë në bazë të kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjes vetëqeverisëse mbi bashkimin respektivisht në bazë të aktit mbi themelimin.

Këto organizata, bashkësi e shoqata dhe të drejtat, obligimet e përgjegjësitë e tyre në qarkullimin juridik regjistrohen në regjistrin e organizatave të punës së bashkuar.

Neni 45

Ndaj organizatës së punës së bashkuar dhe bashkësisë ose shoqatës tjetër të këtyre organizatave në të cilat rregullohet esencialisht realizimi i të drejtave vetëqeverisëse të punëtorëve, ose të cilat nuk përmbushin obligimet e përcaktuara me ligj ose dëmtojnë rëndë interesat shoqërore, në kushtet dhe në procedurën e përcaktuar me ligj, mund të merren masa të përkohshme të caktuara me ligj. Kur kjo është e domosdoshme për menjanimin e këtyre dukurive, me këto masa mund të kufizohet përkohësisht realizimi i disa të drejtave vetëqeverisëse të punëtorëve, respektivisht të drejtave të organizatës ose të shoqatave dhe të organeve të tyre.

Neni 46

Në qoftë se në organizatën e punës së bashkuar lind konflikti midis punëtorëve të disa pjesëve të organizatës, respektivisht punëtorëve dhe organeve të organizatës ose punëtorëve të organizatës dhe

organeve të bashkësisë shoqërore-politike, që nuk ka mundur të zgjidhet në mënyrë të rregullt, punëtorët kanë të drejtë dhe për detyrë që kërkesat e veta me rastin e konfliktit që ka lindur t'i paraqesin nëpërmjet organizatës sindikale.

Organizata sindikale ka të drejtë dhe për detyrë që, me kërkesën e punëtorëve ose me iniciativën e vet, të fillojë procedurën për zgjidhjen e konfliktit që ka lindur dhe që në këtë procedurë, bashkë me organet përkatëse të qeverisjes të organizatës së punës së bashkuar, respektivisht me organet e bashkësisë shoqërore-politike, t'i caktojë bazat dhe masat për zgjidhjen e çështjeve që kanë shkaktuar konfliktin.

Neni 47

Organizata e punës së bashkuar respektivisht organizata e bashkimit afar që ushtron veprimtari ekonomike, në kushtet dhe sipas procedurës që janë përcaktuar me ligjin federativ, mund të suprimohet në qoftë se nuk përmbush kushtet e përcaktuara me ligj për ushtrimin e veprimtarisë së vet, nëse për një kohë të gjatë nuk është në gjendje t'i përtrijë mjetet shoqërore me të cilat punon dhe të sigurojë realizimin e të drejtave të punëtorëve të garantuara me kushtetutë sa i përket sigurisë së tyre materiale e sociale, apo nëse nuk është në gjendje t'i përmbush obligimet e tjera të përcaktuara me ligj ose që i ka marrë përsipër me kontratë.

Organizata e punës së bashkuar që ushtron veprimtarinë shoqërore, në kushte dhe sipas procedurës që janë përcaktuar me ligj, mund të suprimohet, po që se nuk plotëson kushtet e përcaktuara me ligj apo nëse nuk ka kushte për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Neni 48

Me ligj dhe me vendimin e kuvendit të bashkësisë shoqërore-politike të bazuar në ligj mund të përcaktohet se janë me interes të veçantë shoqëror veprimtaritë ose punët e caktuara të organizatave

të punës së bashkuar që ushtrojnë veprimtaritë shoqërore dhe të rregullohet mënyra e realizimit të interesit të veçantë shoqëror dhe të realizimit të drejtave vetëqeverisëse të punëtorëve në pajtim me këtë interes.

Me ligj dhe me vendimin e kuvendit të bashkësisë shoqërore-politike të bazuar në ligj nëse këtë e kërkon interesi i veçantë shoqëror, mund të rregullohet mënyra e realizimit të këtij interesi në veprimtarinë e organizatave të punës së bashkuar që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike, kur kjo veprimtari është kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe punës së qytetarëve ose i punës së organizatave të tjera në rajonin e caktuar.

Realizimi i interesit të veçantë shoqëror në ushtrimin e këtyre veprimtarive, në pajtim me ligjin, respektivisht me vendimin e kuvendit të bashkësisë shoqërore-politike të bazuar në ligj, sigurohet: me marrëveshjen vetëqeverisëse dhe marrëveshjen shoqërore; me pjesëmarrjen e shfrytëzuesve të shërbimeve, përfaqësuesve të themeluesit, bashkësive shoqërore-politike e organizatave shoqërore-politike dhe të organizatave e të bashkësive të tjera të interesuara në realizimin e interesave të përbashkëta; me përcaktimin e destinimit themelor të shfrytëzimit të mjeteve dhe të kushteve themelore të fitimit të të ardhurave e të veprimtarisë; me programet e zhvillimit; me pjesëmarrjen në emërimin dhe shkarkimin nga detyra të organeve punëdrejtuese të organizatave të punës së bashkuar që ushtrojnë këto veprimtari, dhe me forma të tjera të ndikimit shoqëror në ushtrimin e këtyre veprimtarive.

Me ligj mund të autorizohet kuvendi i bashkësisë shoqërore-politike të japë pëlqimin për dispozitat e marrëveshjes vetëqeverisëse mbi bashkimin, statutin ose aktin tjetër vetëqeverisës të organizatës së punës së bashkuar që ushtron veprimtarinë me interes të veçantë shoqëror, që janë me rëndësi për realizimin e interesit të veçantë shoqëror në ushtrimin e këtyre veprimtarive.

Punëtorëve të organizatave të punës së bashkuar që ushtrojnë veprimtarinë me interes të veçantë shoqëror nuk mund t'u kufizohen të drejtat e garan-

tuara me kushtetutë që kanë të bëjnë me punën dhe drejtimin e mjeteve shoqërore, rregullimin e marrëdhënjeve reciproke në punë dhe fitimin e të ardhurave personale.

Neni 49

Organizatave të punës së bashkuar që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike dhe shoqatat e tyre afare bashkohen në oda ekonomike ose në shoqata të tjera të përgjithshme për përparimin e përbashkët të punës e të veprimtarisë, për harmonizimin e interesave të veçanta, të përbashkëta e të përgjithshme shoqërore për t'u marrë vesh mbi planet dhe programet e punës e të zhvillimit dhe mbi rregullimin vetëqeverisës të marrëdhënjeve shoqërore-ekonomike, për marrjen e iniciativës për lidhjen e marrëveshjeve vetëqeverisëse dhe marrëveshjeve shoqërore, për nxjerrjen e ligjeve, për përcaktimin e politikës ekonomike dhe për shqyrtimin e zgjidhjen e çështjeve të tjera me interes të përbashkët.

Për realizimin e këtyre qëllimeve edhe organizatat e punës së bashkuar që ushtrojnë veprimtarinë shoqërore mund të bashkohen në shoqata për disa veprimtari, respektivisht lëmë të punës, dhe në shoqata të tjera të përgjithshme.

3. Bashkësitë vetëqeverisëse të interesit

Neni 50

Bashkësitë vetëqeverisëse të interesit i themelojnë njerëzit punues në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të organizatave e të bashkësive të tyre vetëqeverisëse për plotësimin e nevojave e interesave të veta personale e të përbashkëta dhe për harmonizimin e punës në lëmën për të cilën themelojnë bashkësinë e interesit me këto nevoja dhe interesa.

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë në marrëdhënjet reciproke në bashkësinë vetëqeverisëse të interesit rregullohen me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi themelimin e saj, me statutin dhe aktet e tjera vetëqeverisëse të saj.

Për plotësimin e nevojave dhe interesave të veta në bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, njerëzit punues u paguajnë kontribute këtyre bashkësive nga të ardhurat e tyre personale dhe nga të ardhurat e organizatave themelore të punës së bashkuar, në pajtim me destinimin, respektivisht me qëllimet për të cilat shërbejnë këto mjete.

Neni 51

Punëtorët dhe njerëzit e tjerë punues të cilët në lëmët e arësimit, shkencës, kulturës, shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale sipas parimeve të reciprocitetit e të solidaritetit realizojnë nevojat dhe interesat e veta personale e të përbashkëta dhe punëtorët e organizatave të punës së bashkuar që ushtrojnë veprimtarinë në këto lëmë, themelojnë bashkësi vetëqeverisëse të interesit në të cilat realizojnë këmbimin e lirë të punës, bashkojnë punën e mjetet dhe vendosin në mënyrë të barabartë e të përbashkët mbi ushtrimin e këtyre veprimtarive në pajtim me interesat e përbashkëta, përcaktojnë politikën e zhvillimit e të përparimit të këtyre veprimtarive dhe realizojnë interesat e tjera të përbashkëta.

Marrëdhënjet reciproke në këto bashkësi vetëqeverisëse të interesit rregullohen ashtu që të sigurohet e drejta e punëtorëve dhe e njerëzve të tjerë punues që i bashkojnë mjetet në to që të vendosin mbi këto mjete dhe e drejta e punëtorëve të organizatave të punës së bashkuar që ushtrojnë veprimtarinë në lëmën për të cilën është themeluar bashkësia e interesit që në këmbimin e lirë të punës të realizojnë pozitën e njëjtë shoqërore-ekonomike sikurse punëtorët në organizatat e tjera të punës së bashkuar.

Mbi këto baza mund të themelohen bashkësi vetëqeverisëse të interesit edhe në lëmët e tjera të veprimtarive shoqërore.

Neni 52

Për të siguruar sigurinë e vet sociale, njerëzit punues themelojnë bashkësi vetëqeverisëse të in-

teresit të sigurimit pensional e invalidor ose të formave tjera të sigurimit social, në të cilat bashkojnë mjetet për këtë qëllim dhe sipas parimeve të reciprocitetit e të solidaritetit dhe të punës së tejshkuar, përcaktojnë obligimet e veta të përbashkëta e individuale ndaj këtyre bashkësive dhe të drejtat e përbashkëta e individuale që i realizojnë në to.

Mbi këto baza mund të themelohen bashkësi vetëqeverisëse të interesit edhe në lëmët e tjera, në të cilat me bashkimin e mjeteve në fonde të përbashkëta, realizohen interesat e caktuara të përbashkëta sipas parimeve të reciprocitetit e të solidaritetit.

Neni 53

Njerëzit punues, drejtpërdrejt dhe nëpërmjet organizatave të veta të punës së bashkuar dhe organizatave e bashkësive të tjera vetëqeverisëse, themelojnë bashkësi vetëqeverisëse të interesit në lëmën e banesave, në të cilat këto organizata dhe bashkësi bashkojnë mjetet për ndërtimin e banesave, përcaktojnë politikën dhe programin e këtij ndërtimi dhe bashkë me banuesit qeverisin ndërtesat e banimit dhe banesat në pronësinë shoqërore dhe realizojnë interesat e tjera të përbashkëta.

Neni 54

Në lëmën e veprimtarive komunale, të energjetikës, të ekonomisë ujore, të komunikacionit dhe të veprimtarive të tjera të prodhimit material, nëse ushtrimi i vazhdueshëm i këtyre veprimtarive është i domosdoshëm për plotësimin e nevojave të shfrytëzuesve të caktuar, mund të themelohen bashkësi vetëqeverisëse të interesit të organizatave të punës së bashkuar të këtyre lëmëve dhe të shfrytëzuesve të prodhimeve e të shërbimeve të tyre në të cilat ata realizojnë interesat e përbashkëta të përcaktuara me marrëveshjen vetëqeverisëse.

Neni 55

Për realizimin sa më të drejtpërdrejtë të të drejtave dhe interesave të tyre vetëqeverisëse, punëtorët

dhe njerëzit e tjerë punues dhe organizatat e tyre të punës së bashkuar dhe organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse — anëtarët e bashkësisë vetëqeverisëse të interesit kanë të drejtë që në bashkësinë e interesit, në kushtet e përcaktuara me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi themelimin e bashkësisë vetëqeverisëse të interesit ose me statutin e saj, të organizohen në bashkësi ose njësi themelore për rajonin e caktuar ose për realizimin e interesave të caktuara të përbashkëta dhe që në këtë bashkësi, respektivisht njësi themelore, t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre të caktuara vetëqeverisëse.

Bashkësitë vetëqeverisëse të interesit mund të bashkohen në bashkësi të gjera vetëqeverisëse të interesit dhe të formojnë bashkime e shoqata të tjera të bashkësive të interesit, si dhe të vendosin forma të tjera bashkëpunimi reciprok.

Kur bashkësia vetëqeverisëse e interesit themelohet për një rajon më të gjerë se territori i komunës, për territoret e komunave mund të themelohen bashkësitë si pjesë të kësaj bashkësie vetëqeverisëse të interesit.

Neni 56

Bashkësia vetëqeverisëse e interesit dhe bashkësitë e njësitë themelore në kuadër të saj, si dhe shoqatat e bashkësive vetëqeverisëse të interesit, janë persona juridikë me të drejta, obligime dhe përgjegjësi që kanë në bazë të kushtetutës, ligjit, marrëveshjes vetëqeverisëse mbi themelimin e bashkësisë së interesit, respektivisht shoqatës së bashkësive të interesit dhe statutit të tyre.

Neni 57

Me ligj, respektivisht me vendim të kuvendit të bashkësisë shoqërore-politike të bazuar në ligj, mund të përcaktohet obligimi i themelimit, respektivisht të themelohet bashkësia vetëqeverisëse e interesit, kur veprimtaritë, respektivisht punët e caktuara të bashkësisë së këtillë, janë me interes të veçantë shoqëror, si dhe të përcaktohen parimet për organizi-

min e saj dhe për marrëdhënjet reciproke në të dhe të përcaktohet obligimi i pagimit të kontributit kë-saj bashkësie.

Veprimtaritë, respektivisht punët për të cilat me ligj ose me vendim të kuvendit të bashkësisë shoqë-rore-politike të bazuar në ligj është përcaktuar se janë me interes të veçantë shoqëror, bashkësia vetë-qeverisëse e interesit ka për detyrë t'i ushtrojë në mënyrën e përcaktuar me ligj, respektivisht me ven-dim të kuvendit të bashkësisë shoqërore-politike.

Neni 58

Në goftë se në bashkësinë vetëqeverisëse të in-teresit që ushtron veprimtari, respektivisht punë të caktuara që janë me interes të veçantë shoqëror, nuk merret vendimi mbi çështjen nga e cila varet esencialisht puna e bashkësisë së interesit, kuvendi i bashkësisë shoqërore-politike, në kushtet dhe sipas procedurës që janë përcaktuar me ligj, mund të marr vendimin me të cilin zgjidhet përkohësisht kjo çështje.

Ndaj bashkësisë vetëqeverisëse të interesit mund të merren masa të përkohshme të përcaktuara me ligj në rastet dhe në kushtet kur mund të merren masa të këtilla ndaj organizatave të punës së bashkuar.

4. Mjetet e organizatave shoqërore-politike dhe të organizatave të tjera shoqërore

Neni 59

Organizatave shoqërore-politike dhe organizatat e tjera shoqërore të caktuara me ligj mund të fitojnë mjete, respektivisht të drejta të caktuara mbi mjetet, dhe këto mjete si mjete shoqërore t'i përdorin për realizimin e qëllimeve të veta dhe t'i disponojnë në pajtim me statutin e këtyre organizatave dhe me ligjin. Këto organizata, në kushte të përcaktuara me ligj, mund të organizojnë veprimtarinë ekonomike e

veprimtarinë tjetër në pajtim me qëllimet e veta dhe të marrin pjesë në të ardhurat e realizuara me veprimtari të tillë për realizimin e këtyre qëllimeve.

5. Pozita shoqërore-ekonomike dhe bashkimi i bujqëve

Neni 60

Bujkut dhe anëtarit të familjes së tij që merret me bujqësi i garantohet e drejta që, duke punuar me mjetet mbi të cilat ekziston e drejta e pronësisë, të realizojë pozitën vetëqeverisëse të përcaktuar me kushtet në marrëdhënjet shoqërore-ekonomike so-cialiste, të disponojë rezultatet e arritura të punës së vet, t'i plotësojë nevojat e veta personale e shoqë-rore dhe në bazë të kontributit të vet, të realizojë sigurinë e vet sociale sipas parimeve të reciprocitetit e të solidaritetit.

Në bazë të punës personale bujqit kanë pari-misht pozitë të njëjtë dhe në esencë të drejta të njëjta sikurse punëtorët në punën e bashkuar me mjetet shoqërore. Të drejta dhe obligime përkatëse kanë bujqit edhe sa i përket bashkimit të punës e të mjeteve, si dhe në marrëdhënjet e këmbimit në treg dhe në marrëdhënjet e kredive.

Neni 61

Bujqit punën dhe mjetet e veta të punës mund t'i bashkojnë në kooperativat bujqësore dhe në for-mat e tjera të bashkimit të bujqëve ose ti bashkojnë me organizatat e punës së bashkuar.

Kooperativa bujqësore parimisht ka pozitën, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e organizatës së punës së bashkuar.

Bujqit mund të ruajnë të drejtën e pronësisë mbi mjetet që i bashkojnë në kooperativën bujqëso-re ose të përcaktojnë të drejtën e rikthimit të vlerës së këtyre mjeteve dhe të drejtat e tjera në bazë të bashkimit të tyre, në pajtim me kontratën mbi këtë bashkim dhe me statutin e kooperativës.

Nga të ardhurat që realizon kooperativa bujqësore me veprimtarinë e vet, bujqëve që bashkojnë punën dhe mjetet e veta në kooperativë u takon pjesa e të ardhurave në përpjestim me kontributin që e kanë dhënë në realizimin e këtyre të ardhurave me punën e vet dhe me bashkimin e mjeteve, respektivisht me bashkëpunimin me kooperativën. Pjesa e të ardhurave që realizon kooperativa mbi këtë shumë, derdhet si pronë shoqërore në fondet e kooperativës bujqësore dhe shfrytëzohet për zgjerimin dhe përparimin e veprimtarisë së saj.

Neni 62

Duke bashkuar në mënyrë të lirë e të barabartë punën dhe mjetet e veta të punës me punëtorët në punën e bashkuar me mjetet shoqërore, bujqit zgjerojnë bazën materiale të punës së vet dhe shfrytëzojnë rezultatet e zhvillimit të përgjithshëm material e shoqëror dhe mbi këtë bazë plotësojnë në mënyrë më të plotë nevojat e veta personale e shoqërore dhe zhvillojnë aftësitë e punës dhe aftësitë e tjera të veta.

Bujqit që bashkojnë punën dhe mjetet e veta të punës, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet të kooperativës bujqësore ose formës tjetër të bashkimit të bujqëve, me organizatën e punës së bashkuar dhe bashkëpunojnë vazhdimisht me të, drejtojnë në mënyrë të barabartë me punëtorët e kësaj organizate punët e përbashkëta, vendosin bashkarisht mbi të ardhurat e realizuara bashkarisht dhe marrin pjesë në ndarjen e tyre sipas kontributit të vet në realizimin e këtyre të ardhurave, në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse.

Neni 63

Me ligj mund të përcaktohet obligimi që bujqit të bashkohen ose në ndonjë mënyrë tjetër të lidhen me organizatat e punës së bashkuar për kryerjen e meliorimeve, mbrojtjen nga ujërat, breshëri dhe erozionet ose për regullimin e rrëkeve, si dhe në rast

interesi të veçantë shoqëror për kultivimin dhe shfrytëzimin e pyjeve.

Neni 64

Bashkësia shoqërore kujdeset mbi sigurimin e kushteve të përgjithshme për realizimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm të bujqve me kooperativat dhe organizatat e tjera të punës së bashkuar.

Kooperativat dhe format e tjera të bashkimit të bujqve bashkohen në oda dhe shoqata të tjera të përgjithshme, në pajtim me ligjin.

6. Puna e pavarur personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve

Neni 65

Garantohet liria e punës së pavarur personale me mjetet e punës në pronësinë e qytetarëve kur ushtrimi i veprimtarive me punë personale i përgjigjet mënyrës, bazës materiale dhe mundësive të punës personale dhe kur nuk është në kundërshtim me parimin e fitimit të të ardhurave sipas punës dhe me bazat e tjera të rregullimit shoqëror socialist.

Me ligj rregullohen kushtet e ushtrimit të veprimtarive me punën e pavarur personale me mjetet e punës në pronësinë e qytetarëve dhe të drejtat pronësore mbi mjetet e punës dhe lokalet e punës, që perdorin për ushtrimin e veprimtarive me punë të pavarur personale.

Me ligj, kur këtë e kërkon interesi shoqëror, mund të caktohen veprimtaritë që nuk mund të ushtrohen me punë të pavarur personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve.

Neni 66

Njerëzit punues që ushtrojnë pavarësisht veprimtarinë me punë personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve, mund të themelojnë kooperativën dhe në të, sipas parimeve të barazisë, të bashkojnë punën dhe mjetet e veta të punës dhe t'i disponojnë bashkarisht të ardhurat që i reagon kooperativa.

Kooperativa që e themelojnë njerëzit punues që ushtrojnë pavarësisht veprimtarinë me punë personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve, ka pozitën, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e kooperativës bujqësore, e anëtarët e saj kanë pozitën, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë sikurse anëtarët e kooperativës bujqësore.

Neni 67

Njerëzit punues që ushtrojnë pavarësisht veprimtarinë me punë personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve, në pajtim me kontratën dhe ligjin, punën dhe mjetet e veta të punës mund t'i bashkojnë me organizatat e punës së bashkuar në forma të ndryshme kooperimi dhe forma të tjera bashkëpunimi afar. Në kuadër të këtij bashkëpunimi këta njerëz punues marrin pjesë në drejtimin e punëve të përbashkëta, vendosin së bashku mbi të ardhurat e realizuara bashkarisht dhe marrin pjesë në ndarjen e tyre në përpjestim me kontributin e vet në realizimin e këtyre të ardhurave.

Neni 68

Njeriu punues që ushtron pavarësisht veprimtarinë me punë personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve, në baza të vetëqeverisjes, mund të bashkojë punën dhe mjetet e veta të punës me punën e personave të tjerë në kuadër të organizatës me kontratë të punës së bashkuar.

Njeriu punues që në organizatën me kontratë ka bashkuar punën dhe mjetet e veta me punën e personave të tjerë ka të drejtë që, si punëdrejtues, të drejtojë veprimtarinë e organizatës me kontratë dhe që, bashkë me punëtorët, të vendos mbi punën dhe zhvillimin e saj.

Punëdrejtuesit dhe punëtorëve në organizatën me kontratë të punës së bashkuar u takojnë, në bazë të punës së tyre, mjetet për plotësimin e nevojave personale e të përbashkëta, e punëdrejtuesit në bazë të mjeteve që i ka bashkuar i takon edhe pjesa e të ardhurave në pajtim me parimet që vlejné për

bashkimin e punës e të mjeteve shoqërore në organizatat e punës së bashkuar.

Pjesa e të ardhurave të realizuara në organizatën me kontratë të punës së bashkuar, që mbetet pasi të ndahen mjetet për plotësimin e nevojave personale e të përbashkëta të punëdrejtuesit e të punëtorëve dhe pjesa e të ardhurave për punëdrejtuesin në bazë të mjeteve që ka bashkuar, është pronë shoqërore. Punëtorët, bashkë me punëdrejtuesin, drejtojnë, në bazë të punës së vet, këtë pjesë të të ardhurave si mjete shoqërore.

Kushtet dhe mënyra e themelimit dhe e veprimtarisë së organizatës me kontratë të punës së bashkuar, si dhe të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e saj rregullohen me ligj, e të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë reciproke të punëdrejtuesit e të punëtorëve rregullohen me kontratë në pajtim me ligjin. Me kontratë rregullohen edhe mënyra dhe kushtet e bashkimit të mjeteve, si dhe mënyra dhe kushtet e tërheqjes, respektivisht pagesës së mjeteve që punëdrejtuesi i ka futur në organizatën me kontratë.

Punëdrejtuesi i organizatës me kontratë të punës së bashkuar ruan të drejtën e pronësisë mbi mjetet që ka bashkuar në këtë organizatë. Me tërheqjen, respektivisht me pagesën e këtyre mjeteve, punëdrejtuesit i shuhet të drejtat që i ka si punëdrejtues në organizatën me kontratë.

Neni 69

Me ligj caktohet në cilat veprimtari, në pajtim me natyrën e tyre dhe me nevojat shoqërore, dhe në çfarë kushtesh njeriu punues që ushtron pavarësisht veprimtarinë me punë personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve, përjashtimisht dhe në një vëllim të kufizuar, pa themelimin e organizatës me kontratë të punës së bashkuar, mund të përdorë punën plotësuese të personave të tjerë me inkuadrimin e tyre në punë.

Kontratën e inkuadrimit në punë e lidhin njeriu punues dhe punëtorët që i inkuadron në punë në pajtim me kontratën kolektive, të cilën e lidhin organizata sindikale dhe oda ekonomike përkatëse, res-

pektivisht shoqata tjetër në të cilën janë të përfaqësuar njerëzit punues që ushtrojnë pavarësisht veprimtari me punë personale me mjetet në pronësi në e qytetarëve. Me kontratën kolektive u sigurohet këtyre punëtorëve, në pajtim me të drejtat e punëtorëve në punën e bashkuar, e drejta për mjetet për plotësimin e nevojave personale e të përbashkëta dhe të drejtat e tjera që sigurojnë sigurinë e tyre materiale dhe sociale.

Me ligj mund të caktohet se pjesa e të ardhurave që është rezultat i mbipunës së punëtorëve të inkuadruar në punë të njeriu punues që ushtron pavarësisht veprimtarinë me punë personale me mjetet në pronësinë e qytetarëve, është pronë shoqërore dhe se përdoret për nevojat e zhvillimit.

7. Planifikimi shoqëror

Neni 70

Punëtorët në organizatat themelore e organizatat e tjera të punës së bashkuar dhe njerëzit punues në bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, bashkësitë lokale dhe në organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse në të cilat drejtojnë punët dhe mjetet e riprodhimit shoqëror kanë të drejtë dhe për detyrë që, duke u mbështetur në të mbërrimet e shkencës dhe në vlerësimet e mundësive të zhvillimit që bazohen në to dhe duke i përfilluar ligjshmëritë ekonomike, të nxjerrin pavarësisht plane dhe programe të punës e të zhvillimit të organizatave e të bashkësive të veta, që këto plane e programe t'i harmonizojnë midis tyre dhe me planet shoqërore të bashkësive shoqërore-politike dhe që mbi këtë bazë të sigurojnë harmonizimin e marrëdhënjeve në tërësinë e riprodhimit shoqëror dhe orientimin e mbarë zhvillimit material e shoqëror, në pajtim me interesat dhe qëllimet e përbashkëta të përcaktuara në baza të vetëqeverisjes.

Neni 71

Planet dhe programet e punës e të zhvillimit të organizatave themelore të punës së bashkuar dhe të

organizatave të punës së bashkuar në kuadër të të cilave janë nxiren dhe realizohen në raportet e bashkëpunimit e të varësisë reciproke që rrjedhin nga bashkimi i punës dhe i mjeteve në këto organizata në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse, duke siguruar të drejtën e punëtorëve që në organizatat themelore të punës së bashkuar të vendosin mbi nxjerrjen e këtyre planeve dhe programeve.

Organizatat themelore dhe organizatat e tjera të punës së bashkuar, të bashkuara në bashkësi vetëqeverisëse të interesit ose në organizata e bashkësi të tjera vetëqeverisëse, nxjerrin dhe realizojnë planet e programet e veta të punës e të zhvillimit në pajtim me interesat dhe qëllimet e përbashkëta, respektivisht në pajtim me planet dhe programet e përbashkëta, të cilat i përcaktojnë me marrëveshje në kuadër të këtyre organizatave, respektivisht bashkësive vetëqeverisëse.

Organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë vetëqeverisëse të interesit dhe organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse harmonizojnë planet dhe programet e veta të punës e të zhvillimit edhe me planet e programet e organizatave e të bashkësive të tjera vetëqeverisëse me të cilat kanë interesa dhe qëllime të caktuara të përbashkëta, që rrjedhin nga bashkëpunimi i tyre dhe nga varësia reciproke në riprodhimin shoqëror dhe të cilat i përcaktojnë me marrëveshjen vetëqeverisëse.

Obligimet reciproke, të cilat organizatat themelore dhe organizatat e tjera të punës së bashkuar dhe organizatat e bashkësitë e tjera vetëqeverisëse i kanë përcaktuar me marrëveshje për të realizuar planin e përbashkët, për kohën për të cilën është përcaktuar plani nuk mund të prishen, respektivisht të ndryshohen në mënyrë të njëanshme.

Neni 72

Në bazë të marrëveshjes për interesat dhe qëllimet e përbashkëta të zhvillimit ekonomik e shoqëror në komunë e në Krahinë dhe në bazë të planeve e programeve të punës e të zhvillimit të organizatave të punës së bashkuar, të bashkësive vetëqeveri-